

... të fëmijëve në transmetime
... esën e Autoritetit të Media
... ive që prej muajit prill ka
... tur më **Buletini i** shumë
... mendime **Lëshillit të** për
... cilave kanë **Ankesave.** Në
... të drejtë të kërkojë, të het
... të marrë dhe të ndajë info
... dhe ide, pa asnjë lloj censi
... dios, tu dhe mjeteve të tje
... ikimit audioviziv apo ndo
... tjetër bazuar në përsqjed
... m nëse këtë e bën në kuad
... timit të sundin
... tave të njeriut.
... me krijimin e shërbimeve



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Nr. 14

QERSHOR 2023

Përmbajtja

Hyrje	04
Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave	06
Statistika	09
SEKSIONI I	
Ankesa me objekt "cenimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit"	12
SEKSIONI II	
Ankesa me objekt "cenimin e të drejtave të fëmijëve"	42
SEKSIONI III	
Komunikime tregtare të ndaluara	50
SEKSIONI IV	
Ankesa jashtë objektit të veprimtarisë	53
SEKSIONI V	
Ankesa me objekt të ndryshëm & Kërkesa për informacion	64

Dy fjalë

në vend të hyrjes

Këshilli i Ankesave si strukturë në përbërje të Autoritetit të Mediave Audiovizive, vepron në zbatim të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodit të Transmetimit, rregulloreve dhe udhëzimeve të tjera, miratuar prej AMA-s si edhe në promovim të praktikave më të mira në tregun e transmetimeve audiovizive.

Në përmbushje të detyrimit ligjor, sipas ligjit nr. 97/2013, neni 20, pika 7, Këshilli i Ankesave publikon në mënyrë periodike Buletinin e Ankesave. Buletini i 14-të përmban ankesat e trajtuara gjatë periudhës Janar-Qershor 2023. Nga praktikat e ankesave të administruara rezulton se operatorët e shërbimit mediatik audioviziv në transmetimet e tyre vijojnë të mos plotësojnë pritshmëritë e publikut përkitazi mënyrës së përpunimit dhe përdorjes së të dhënave personale, me pasojë dëmtimin e imazhit, cenimin e privatësisë, pavarësisht pranisë ose jo të interesit publik.

Të tjera aspekte problematike të sinjalizuara nga ankuesit kanë të bëjnë kryesisht me formatet "reality show", ku prania apo promovimi i disa sjelljeve dhe modeleve kërkon trajtim me kujdes dhe përgjegjësi të këtyre formateve, me synim shmangien e keqkuptimeve dhe promovimin qoftë dhe të pandërgjegjshëm të sjelljeve, që bien ndesh me dispozitat ligjore.

Përkitazi mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe interesit të tyre, nga administrimi i ankesave rezulton, se OSHMA-të vijojnë të mos respektojnë orarin e transmetimit apo vendosjen e shenjave paralajmëruese për

përmbajtje të dëmshme për zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijëve.

Në situatat e sipërpërmendura, Këshilli i Ankesave, bazuar në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodin e Transmetimit, ka dhënë masa paralajmëruese ose sanksione financiare, në përputhje me llojin dhe përsëritjen e shmangies/shkeljes dhe u ka kërkuar OSHMA-ve respektimin e kërkesave të ligjit dhe Kodit të Transmetimit në të ardhmen.

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive kanë vijuar t'i drejtohen edhe ankesa lidhur me publikime në rrjetet sociale apo mediat online, të cilat sipas përcaktimeve të ligjit të sipërcituar, janë jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive. Edhe pas ndryshimeve të fundit, të prillit 2023, konkretisht me ligjin 30/2023 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë"*", mediat online mbeten jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit.

Procesi i trajtimit

të ankesave nga

Këshilli i Ankesave

Mbështetur në ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodin e Transmetimit, shikuesit dhe dëgjuesit e subjekteve audiovizive kanë të drejtë të ankohen rreth përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, nëse ata besojnë dhe mendojnë që subjektet kanë cenuar apo shkelur parimet dhe rregullat etike, bazuar në ligjin nr. 97/2013 dhe në Kodin e Transmetimit. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht disa elementë, si: llojin e shkeljes së pretenduar referuar Ligjit apo Kodit, programin apo emisionin, të cilit ankesa i referohet, datën dhe orën e transmetimit. Ligji "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodi i Transmetimit mund të gje nden në faqen zyrtare të AMA-s: www.ama.gov.al.

Në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive gjeni dhe formularin përkatës të ankesës. Pasi të klikoni në rubrikën "Formular ankesë për shkeljen e Kodit të Transmetimit", mund ta plotësoni atë me të dhënat e kërkuara ose mund të shkruani në adresën zyrtare të AMA-s: info@ama.gov.al. Në përputhje me mënyrën dhe procesin e ankimit, shikuesi apo dëgjuesi duhet ta dërgojë ankesën në adresën që gjendet në fund të fletës së ankesës, pasi ka lexuar me kujdes udhëzimet për hartimin e saj, por mbi të gjitha parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit.

Në disa raste, publiku mund t'ia drejtojë ankesat e veta OSHMA-ve në mënyrë të drejtpërdrejtë, kur e mendon se kjo është një rrugë më e shpejtë që subjekti të reflektojë. Kur shikuesi apo dëgjuesi nuk mbetet i kënaqur me përgjigjen nga OSHMA-ja ose, nëse OSHMA-ja nuk përgjigjet, atëherë ai mund ta referojë ankesën e tij në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në faqen e tij zyrtare ose me postë.

Këshilli i Ankesave shqyrton çdo ankesë, që i mbërrin, bazuar në ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodin e Transmetimit, në pretendimet e palëve si edhe në përmbajtjen audiovizive të transmetuar. Ankesat shqyrtohen në nivel ekzekutiv nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të AMA-s, si Drejtoria e Programeve dhe Monitorimit, Drejtoria Ligjore dhe ajo e Mbikqyrjes.

Detajet e shqyrtimit dhe vendimet lidhur me ankesat për përmbajtjen e transmetimeve audiovizive të marra nga Këshilli i Ankesave publikohen çdo gjashtë muaj në Buletinin e Këshillit të Ankesave.

Statistika

Ankesat në shifra

Në periudhën Janar – Qershor 2023 u adresuan 310 ankesa, prej të cilave:


180 – me objekt shkeljen e të drejtave të njeriut, dinjitetit, normave ligjore dhe etike

60 – me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijës

10 – me objekt shkeljen e dispozitave për komunikimet me natyrë tregtare

40 – me objekt shkelje të ndryshme

20 – me objekt jashtë objektivit të veprimtarisë së AMA-s



Ankesat në përqindje


58% – me objekt shkeljen e të drejtave të njeriut, dinjitetit, normave ligjore dhe etike

19.5 % – me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijës

3.2% – me objekt shkeljen e dispozitave për komunikimet me natyrë tregtare

12.9% – me objekt shkelje të ndryshme

6.4% – me objekt jashtë objektit të veprimtarisë së AMA-s



1

Ankesa me objekt

"cenimin e rregullave

të etikës dhe dinjitetit"

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.K	"EuroBalkansNews"	"G.morningAlbanians"	15.12.2022

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga E.K. me pretendimin se në emisionin "Goodmorning Albanians" transmetuar në televizionin "EuroBalkansNews" në datën 15 dhjetor 2022, në orën 07:40 *"i ftuari dhe prezantuesja diskutonin, si të ishte një lojë, se në cilat raste do ishte i pranueshëm dënimi me vdekje, duke cituar dhe Kuranin, a thua se kjo e bënte argumentimin më të vlefshëm"* dhe se *"përmbajtje të tilla relativizojnë dhe si pasojë legjitimojnë veprime të pafalshme, si vrasja e një personi, dhe jo vetëm ç'edukojnë shikuesit ..., por nxisin potencialisht veprime ekstremiste dhe të dhunshme"*.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim përmbajtjen audiovizive përkatëse, konkretisht videon e emisionit "Goodmorning Albanians, transmetuar në televizionin "EuroBalkansNews" në datën 15 Dhjetor 2022, ora 07:40 ku konstatoi :

- Trajtimin e temës *"A e legjitimon feja islame dënimin me vdekje"*, nisur nga protestat e zhvilluara në Iran dhe ekzekutimi i dënimit me vdekje të një futbollisti-protestues.
- Diskutimin e temës në studio me disa të ftuar: një teolog, një aktiviste dhe një gazetar.

Në vijim Këshilli i Ankesave shqyrtoi edhe shkresën nr.73 prot, datë 06/01/2023, dërguar

në përgjigje të kërkesës për paraqitje pretendimesh, sipas nenit 51 të Ligjit nr. 97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, rregullores *"Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes"* si edhe udhëzimit *"Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv"*, ku argumentohet se *"Tema... ngrihet në formën e një pyetjeje, për shkak të një vendimi, që ka shkaktuar debat... pretendime të tilla ka patur edhe në mediat ndërkombëtare"*, se *"... moderatorja ka pyetur të ftuarit se si e interpreton feja islame këtë vendim, por në asnjë rast nuk është shprehur apo theksuar se Kurani apo feja islame e legjitimon këtë vendim"* dhe se *"...televizioni nuk ka patur qëllim të nxisë provokime apo sjellje të papërshtatshme, të cilat prekin direkt, indirekt apo dalin kundër një feje të caktuar"*.

Nisur nga sa më sipër si edhe nga parimet themelore të veprimtarisë dhe transmetimeve audiovizive, ku bëjnë pjesë dhe dispozitat e mëposhtme:

- *moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve*
- *moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën*

(Ligji nr.97/2013,"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Neni 4, pika 2/d, dh)

- *Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën,*

diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve.

(Kodi i Transmetimit, Seksioni 1, pika 1.5)

Këshilli i Ankesave, duke vlerësuar rolin e rëndësishëm të medias në trajtimin e temave të tilla sensitive dhe me impakt për interesin publik i solli në vëmendje operatorit audioviziv përkatës domosdoshmërinë e trajtimit me

kujdes dhe përgjegjësi të këtyre problematikave, me synim shmangien e keqkuptimeve dhe promovimin qoftë dhe të pandërgjegjshëm të sjelljeve, që bien ndesh me këto dispozita dhe i kërkoi të mbajë parasysh respektimin e parimeve themelore për transmetimin e mediave audiovizive edhe në të ardhmen.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Reagimi publik	"Vizion Plus"	"7pa5"	09.01.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), në kuadrin e përmbushjes së detyrimit të vet ligjor për "mbikëqyrjen e zbatimit të kodeve dhe rregulloreve nga OSHMA-të", u bë i vëmendshëm nëpërmjet disa mesazhesh të publikut për disa deklarime shqetësuese në televizionin "Vizion Plus" lidhur me vaksinën anti-Covid.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të shqetësimit publik, Këshilli i Ankesave kreu verifikimet e domosdoshme, nga ku rezultoi se në emisionin "7pa5" të datës 09.01.2023, transmetuar në televizionin "Vizion Plus", ku diskutohej rreth pandemisë Covid-19 dhe pasojave të saj në shoqëri, përfshirë pasojat e vaksinimit, një prej të ftuarve, Dr.Luçiano Bardhi, duke folur për vaksinën kundër koronavirusit, ndër të tjera, është shprehur se:

- "Komplikacionet më të shumta nga ky injektim ishin komplikacionet kardiovaskulare, kryesisht: periokarditet, miokarditet, masat intrakardiake ose ekstrakardiake.
- "Sollli inflamacion. Në mjekësi ka vetëm dy patologji ose dy sëmundje: inflamacion dhe kancer. Shumë persona që morën vaksinën, morën injektimin e dytë, të tretë shfaqën dëmtime afatgjata në mushkëri".
- "Injektimet ARNM që u bënë në vitet 2020-2021 sollën me të vërtetë dëmtime

jo vetëm tek pjesa e nënës por edhe tek fetusit. Shumë fëmijë sot kanë lindur me problematika. Fëmijët pas 2020-ës nuk janë aspak fëmijë normalë".

KA/AMA iu drejtua me një kërkesë, nr. Prot. 276, datë 18.01.2023, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Shëndetit Publik, Departamentit të Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive, për mendim/interpretim profesional lidhur me deklaratat e mësipërme.

Në përgjigjen e vet, nr.Prot75/1, datë 27.01.2023, ISHP vë në dukje se:

- "Nuk është vërtetuar asnjë lidhje shkakësore midis vaksinës anti-Covid, miokarditet dhe perikarditet deri më tani.
- Masat intrakardiake apo ekstrakardiake, që nuk kuptohet se për çfarë janë përmendur, nuk ka asnjë të dhënë se lidhen me vaksinën.
- Pretendimet për lindjen e inflamacioneve të reja dhe hiperreagimin e sistemit imun janë përçarje aspak të lidhura me fakte shkencore...personi keqpërdor shprehje.
- Nisur nga dy studime, të kryera brenda vendit, në kuadrin e monitorimit të procesit të vaksinimit si dhe nga të dhënat ndërkombëtare, inflamacionet e reja si edhe dëmtimet afatgjata në mushkëri janë të lidhura me vetë sëmundjen Covid dhe jo me vaksinën anti-Covid.

- *Pretendimi lidhur me injektimet ARNM nuk kuptohet së ku mbështetet, pasi injeksione të tilla në vitet 2020-2021 nuk janë kryer dhe trajtime, që të kenë shkaktuar dëmtime të nënës apo fetusit, nuk ka pasur”.*
- *Shprehja “fëmijët pas vitit 2020 nuk janë normalë” është komplet e pabazë”.*

Pas shqyrtimit të përmbajtjes audiovizive dhe shpjegimeve të sipërpërmendura, rezultoi se burimi kryesor i informacionit për temën ka qenë intervista me një person të prezantuar si ekspert të fushës, ndërkohë që informacioni i dhënë nuk është balancuar apo konfirmuar me burime të tjera. Për shkak të sensibilitetit të temës si pasojë e interesit të lartë publik, të lidhur me pandeminë globale, të shkaktuar nga koronavirusi dhe debatet që e shoqëruan atë, të shtuara ndjeshëm pas daljes së vaksinës anti-Covid, KA/AMA konstatoi **shkelje të Ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në :**

- nenin 33, “Detyrimet e OSHMA-ve”, pika 1/a) *“të njoftojë dhe të paraqesë lajmet e transmetuara në një mënyrë të vërtetë, të paanshme dhe objektive”*
- po aty, pika 1/b) *“të sigurojë që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet, që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për gjitha subjektet e interesuara në*

këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme”.

dhe

shkelje të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, në Seksionin 4, “Transmetimi i programeve informative”:

- pika 4.3: *“Informacioni i transmetuar duhet të jetë i vërtetë, i saktë, i balancuar dhe i verifikuar”.*
- pika 4.5 *“Të gjitha lajmet e transmetuara të publikohen në mënyrë objektive dhe të paanshme”.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave i tërhoqi **vëmendjen televizionit “Vizion Plus”** për shkelje të Ligjit nr.97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017 dhe i kërkoi

- **zbatimin e kërkesave të deontologjisë së profesionit të gazetarit.**
- **fshirjen e emisionit nga llogaria në YouTube dhe çdo prani tjetër online**

duke i rikujtuar subjektit, se **përsëritja e shkeljeve të ngjashme do të penalizohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.**

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.D	"RTSH"	"ADN"	12.01.2023
E.B	"RTSH"	"ADN"	12.01.2023
Kisha Ortodokse			

1. Objekti i Ankesës

Shtetasit A.D dhe E.B iu drejtuan me ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se në emisionin "ADN" të gazetarit Ilir Yzeiri, transmetuar në televizionin publik RTSH, më datë 12 Janar 2023 "moderatori i emisionit në bashkëbisedim me historianin, Pëllumb Xhufi, në mënyrë tendencioze, ofenduese dhe gënjeshtare...shprehej kundër kryepeshkopit të kishës orodokse... duke nxitur urrejtjen dhe konfliktin fetar në Shqipëri...". Sipas shtetasit E.B "...gazetari i besimit musliman, duket se do t'i fryjë luftës së besimeve, duke goditur tolerancën dhe bashkëjetesën mes feve në vendin tonë...".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim përmbajtjen audiovizive përkatëse ku konstatoi :

Trajtimin e temës "Noli, Janullatos, krishtërimi dhe teatri shqiptar" ku në pjesën e parë të emisionit rrëfehej historia e Krishtërit në Shqipëri nga i ftuari në studio, historiani Pëllumb Xhufi, ndërsa në pjesën e dytë, i ftuari regjisor Altin Basha prezantonte veprën teatrale me titull "Jezus Krishti Superstar" me subjekt historinë e Jezus Krishtit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga pretendimet e ankuesve, Këshilli i Ankesave vlerësoi emisionin "ADN" të gazetarit Ilir Yzeiri transmetuar në televizionin publik RTSH në datën 12 Janar 2023 duke u bazuar në Ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit:

- AMA në ushtrimin e funksioneve të veta, siguron "ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias"(neni 18, pika 1/b), përputhur me rëndësinë, që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 22, pika1) i jep çështjes, kur shprehet, se "liria e shprehjes është e garantuar".
- "operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga garantimi i lirisë së shprehjes" (neni 4, pika 2/a)

si edhe në Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017, sipas të cilit

- "OSHMA-të, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, **garantojnë e respektojnë** lirinë dhe të drejtat e njeriut, **lirinë e shprehjes, të drejtën e informimit**, parimin e mosdiskriminimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale" (Seksioni 1, Pika 1.1.)

- "Informacioni i transmetuar duhet të respektojë pluralizmin dhe diversitetin e mendimeve si dhe formimin e lirë të opinionit." (Seksioni 4, Pika 4.4.)

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave **nuk evidentoi përdorim fjalori fyes** ndaj kryetarit të

Kishës Ortodokse ose komunitetit ortodoks në Shqipëri nga ana e gazetarit/moderatorit të emisionit, Ilir Yzeiri, por thjesht paraqitjen e disa fakteve historike, të cilat diskutohen me historianin e ftuar në studio, Prof. Dr. Pëllumb Xhufi dhe për rrjedhojë, **nuk konstatoi shkelje.**

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	"Top Channel"	"Big Brother Vip"	16.01.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërritën dhjetëra ankesa, përmes të cilave pretendohet se në emisionin "Big Brother Vip" transmetuar në televizionin Top Channel, në datën 16 Janar 2023, është përdorur gjuhë urrejtje e që përhap dhunë dhe fjalor i papërshtatshëm mes banorëve të këtij produksioni.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të trajtimit të ankesave, fillimisht Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive nga ku evidentoi se në kanalën me pagesë "Big Brother Vip 1", datë 16 Janar 2023, në fashën orare 01:26 – 01:28, emisioni përmbante një bisedë, e cila rezultonte me shkelje të rënda etike.

Amos: "Të shante njeri gocën time ashtu, për shembull... Me atë lloj ofendimi para gjithë Shqipërisë..."

Kristi: "Çfarë do i bëje, do e vrisje?"

Amos: "Jo, nuk do e vrisja... E di unë çka do i bëja... Atë që meriton. E di çka do i bëja... Do ta çoja në mal... do ta zhvishja lakuriq... do ta xhiroja... do t'i thoja kërko falje ... edhe pastaj e shihje ti, i jep më gojës apo jo."

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialit, Këshilli i Ankesave vlerësoi, se deklaratimet e mësipërme shkelin Ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në:

- nenin 4, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", pika 2/d: "moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve" dhe 2/dh: "moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën"
- nenin 32, "Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive", pika 4 "OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje që nxisin urrejtjen dhe çdo formë tjetër diskriminim".
- nenin 33, "Detyrimet e OSHMA-ve", pika 1/ç: "të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut; pika 1/d: "të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale"

si edhe Kodin e Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 228, datë 11.12.2017, në:

- Seksionin 1 "Parimet themelore", pika 1.5. "Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve", pika 1.6. "Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton normat morale dhe etike të shoqërisë".

Sa më sipër, si edhe duke patur parasysh:

se "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", "Detyrimet e

OSHMA-ve" dhe "Rregullat e përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive", **vlejnë njësoj edhe për transmetimet sipas kërkesës së përdoruesit** (me pagesë) dhe **pavarësisht fashës orare**, Këshilli i Ankesave i tërhoqi

vëmendjen operatorit audioviziv Top Channel dhe i kërkoi **ndalimin e publikimit të videos në kanalin zyrtar në Youtube duke e paralajmëruar se çdo përsëritje do të trajtohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.**

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
G.M	"Top Channel"	"Big Brother Vip"	28.02.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi G.M me pretendimin se *"në formatin Big Brother, produksion i Top Channel, një vajzë është vënë në një cep e rrethuar fillimisht nga një dhe më vonë nga dy burra që i dhunojnë hapësirën personale duke e shtyrë dhe duke mos e lejuar të lëvizë nga cepi. Vajza shihet duke qarë, duke u përpëlitur, duke iu lutur vajzave të tjera që ta ndihmojnë dhe duke u përpjekur të shtyjë burrin që e mbante me forcë fizike në cep."* Sipas ankuesit *"dhunimi i hapësirës personale..., si pjesë e dhunës fizike dhe normalizimi i dhunës në një produksion të një televizioni kombëtar është i papranueshëm."*

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, me sensibilitet dhe angazhim maksimal në raport me çështjen, i bëri me dije ankuesit sa më poshtë vijon :

- Në një produkt audioviziv të kësaj natyre, për standardet etike, përfshirë dhe ato të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përgjigjen jo thjesht dhe vetëm pjesëmarrësit në format, por para së gjithash produksioni dhe vetë Ofruesi i Shërbimit Audioviziv – në këtë rast TOP Channel. Ndaj dhe në raste shkeljesh u takon pikërisht atyre, që të reagojnë të parët në interes të të prekurve dhe publikut, si për të

ndërgjegjësuar të implikuarit në situatë për shkeljet ashtu edhe për të marrë masa për mospërsëritjen e tyre në të ardhmen.

- Këtë rol/funksion në Big Brother VIP Albania e luan/ka moderatorja e formatit, Arbana

Osmani, e cila sipas verifikimeve të KA kishte reaguuar në Prime-n e datës 28.02.2023, si më poshtë:

"Ky është një komunikim zyrtar nga "Big Brother", një patentë ndërkombëtare e "Banijay Group"... Në momente të caktuara disa prej jush; kanë kërcënuar, kanosur, ushtruar presion të fortë psikologjik, dhunuar verbalisht, ofenduar, bullizuar dhe në rastin më të fundit, bllokuar fizikisht me justifikimin "në kuadër të lojës".

"Big Brother" është një format ndërkombëtar, me rregulla ndërkombëtare. Asnjë prej jush që nga ky moment nuk mund të thyejë asnjë prej këtyre rregullave me justifikimin "në kuadër të lojës". Kjo lojë nuk luhet kështu. Kjo lojë luhet duke respektuar liritë dhe të drejtat e gjithsecili pa cenuar askënd. Nëse ndonjëri prej jush lejon për arsye të ndryshme, që këto rregulla të shkelen dhe nuk reagon, duke u justifikuar është përgjegjësi e "Big Brother" të mos e lejojë këtë gjë... Ky është një ultimatum final. Ndaj, në momentin e parë që ndonjëri prej jush do të thyejë rregullat, që të gjithë ju i keni shumë mirë parasysh, konkurrenti do të eliminohet menjëherë. Ky është

paralajmërimi i fundit nga "Big Brother".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, rezultoi, se produktioni i Big Brother VIP Albania dhe OSHMA-ja e **kanë plotësuar detyrimin e tyre** për të reaguar në interes të të prekurit dhe publikut, duke tërhequr vëmendjen e të implikuarve në situatë për shkeljet si edhe duke i ndërgjegjësuar ata për pasojat e përsëritjes së tyre në të ardhmen.

Ankuesit ju bë me dije se pavarësisht reagimit të mësipërm të produktorit të Big Brother VIP Albania, referuar ligjit të vet organik, Këshilli i Ankesave, si pjesë integrale e Autoritetit të Mediave Audiovizive e ka pasur dhe vazhdon ta ketë formatin e sipërpërmendur në vëzhgim dhe ndërkohë i ka tërhequr edhe vëmendjen OSHMA-së (TOP Channel) për shkeljen e Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (neni 33) në këtë format (BBVA)."

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.S	RTSH/ Kanali RTSH1	"Kosherja"	26.03.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë përmes së cilës pretendohet se në emisionin "Kosherja", transmetuar në RTSH1 në datën 26 Mars 2023, në orën 20:35 "Tek episodi "Motër edhe vëlla", aktorja Alba Shtëmbari e kishte quajtur aktorin Ermir Hoxhaj "fshatar" për më shumë se 15 herë gjatë 5 minutave". Sipas ankueses kjo përbënte "diskriminim që i bëhet pjesës së popullsisë, të lindur apo banuese në fshat...?".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të trajtimit të ankesës, fillimisht Këshilli i Ankesave, referuar nenit 51 të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të "RTSH"-së, paraqitjen e pretendimeve lidhur me këtë ankesë.

Në përgjigjen e vet, Nr.1394/1 Prot. datë 11.04.2023, subjekti audioviziv "RTSH" bëri me dije se "në të gjitha rastet fjala nuk ishte përdorur me konotacion negativ apo diskriminues, pasi skeçi evokonte trajtimin e problematikave të ndryshme social-kulturale".

Sipas OSHMA-së, "Njësia e Programeve pasi kishte bërë zbardhjen e materialit humoristik, të transmetuar në episodin e datës 26 mars 2023..., kishte komunikuar me stafin krijues dhe aktorët e spektaklit të humorit..." dhe shprehte bindjen, se "argumentat e parashtruara do të merreshin në konsideratë".

Këshilli i Ankesave shqyrtoi me kujdes videon, konkretisht skeçin "Motër e vëlla" episodi "Vëllai fillon punë" të emisionit "Kosherja", transmetuar në datën 26 Mars 2023. Nga këqyrja e materialit audioviziv u konstatua se fjala "fshatar" përmendej në total 6 herë, në minutazhet 2:23, 3:44, 4:06, 4:19, 4:24, 4:44;

Ndonëse skeçi i referohej aktualitet përmes personazheve humoristike, gjuha e përdorur në to binte ndesh me parimet themelore të Kodit të Transmetimit, sipas të cilit:

- "Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ...". (Seksioni 1, "Parimet Themelore", Pika 1.5)
- "Transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqe si: gjinia, raca, moshë, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër". (Seksioni 4,

"Transmetimi i Programeve Informative")

Megjithatë, nisur nga karakteristikat e zhanrit, produktet artistike, si skeçet apo çdo formë tjetër arti argëtues apo/dhe humoristik duhen parë dhe vlerësuar edhe nga këndvështrimi i lirisë së shprehjes dhe krijimtarisë, për sa kohë liria për t'u shprehur dhe krijuar garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventat Ndërkombëtare dhe Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s i kërkoi stafit të RTSH1 **të tregohen të kujdesshëm në respektimin e kërkesave të Ligjit nr. 97/2013 dhe të Kodit të Transmetimit pa prekur liritë e sipërpërmendura në të gjitha llojet e formateve audiovizive** duke i siguruar njëkohësisht, se do të vazhdojë si deri tani të trajtojë me seriozitet të gjitha ankesat dhe shqetësimet që vijnë për shkelje të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017 si edhe të sensibilizojë të gjithë ofruesit e shërbimeve audiovizive për rëndësinë publike të respektimit të këtyre dispozitave dhe sanksionet ligjore, që burojnë nga shkelja e tyre".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Disa ankues	Top Channel	"Për'puthen"	24.03.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë përmes së cilës pretendohet se në emisionin "Për'puthen" transmetuar në televizionin "Top Channel" në datën 22 Mars 2023, në orën 18.15 "dy vajza u zunë, duke u kërcënuar seriozisht deri në linçim "të pres gishtat...". Sipas ankuesit është përdorur "gjuhë rruge në televizion...gjuhë të fortësh që trembin njerëzit... në një orar që ndiqet nga të rinjtë"."

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, referuar nenit 51 të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave kërkoi nga Bordi i Shqyrtimit të Ankesave pranë televizionit "Top Channel" paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive, rezultoi se materiali përmbante:

- Shkelje të rënda etike gjatë diskutimit midis pjesëmarrësve, ashpërsia e të cilit degradoi në tentativa për dhunë fizike (shtyrje mes vajzave) dhe kërcënime mes tyre ("Kujdes me mua se t'i thyej gishtat"), ("i rraf, i bëj të vdekur në tokë"), etj.
- Fjalor dhe diskutime denigruese, gjuhë agresive dhe bullizuese jo vetëm nga

pjesëmarrësit me njëri-tjetrin por edhe nga opinionistët e ftuar në emision, drejtuar njëres prej pjesëmarrësve ("të veni edhe njëherë atje dhe të rriheni të bëheni të vdekura të dyja...dhe mbase ikni edhe nga emisioni..."), ("na e solle në majë të hundës duke dëgjuar ty dhe hysterizmin tënd..."),("Njëra prej opinionistëve, Neda: Gisel, të lutem kërkoni ndihmë dhe merru me situatat e tua të shëndetit mendor se është e tmerrshme...") dhe opinionisti tjetër Arian Konomi : ("Jo pra nuk i ka mendore, i ka hormone se ka shumë kohë pa bërë dashuri...") etj.

Për pasojë, komunikimi dhe sjellja e mësipërme binte ndesh me Ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në:

- nenin 4, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", pika 2/d: "moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve" dhe 2/dh: "moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën".
- nenin 32, "Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive", pika 4 "OSHMA-të nuk transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi".
- nenin 33, "Detyrimet e OSHMA-ve", pika 1/ç: "të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut", pika 1/d: "të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale".

- nenin 46, "Kodit të Transmetimit", pika 2/dh: "*OSHMA-të nuk lejohet që të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, në veçanti programeqë paraqesin skena dhune..*". dhe

Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, në:

- seksionin 1, pika 1.1: "*OSHMA-të ... garantojnë e respektojnë lirinë dhe të drejtat e njeriut*", pika 1.3: "*respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut*", pika 1.4: "*mbrojnë të drejtat, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*", pika 1.5: "*nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve*", pika 1.6: "*respektojnë normat morale dhe etike të shoqërisë*", pika 1.13: transmetimet me "*elementë të dhunës së skajshme ...u nënshtrohen rregullave të veçanta të një sistemi kontrolli, si ai i aksesit të kushtëzuar apo programeve të kriptuara*", pika 1.16: "*promovojnë dhe mbrojnë mirëqenien, shëndetin e zhvillimin harmonik moral e fizik të fëmijëve*".

- seksionin 5, pika 5.30: "*OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor, ose moral të fëmijëve, në veçanti filma apo*

programe që ... paraqesin skena dhune të skajshme", pika 5.31: "*duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve*", pika 5.34: "*duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. (Ora kufi 22.00 - 06.00)*", pika 5.44: "*për programet që transmetohen në fashën orare 19.00 – 22.00, bëhet i detyrueshëm përdorimi i shenjave paralajmëruese për programet që cenojnë e dëmtojnë fëmijët*".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s i **tërhoqi vëmendjen** televizionit "Top Channel" **për shkelje** të Ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017 dhe i kërkoi :

- **ndalimin e ritransmetimit të emisionit "Për'puthen" të datës 22 Mars 2023,**
- **heqjen e videos përkatëse nga kanali zyrtar në Youtube,**

duke i rikujtuar, se përsëritja e shkeljeve të ngjashme do të penalizohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Disa ankues	"Report TV"	"Pa gjurmë"	07.04.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërritën dy ankesa, në një rën prej të cilave pretendohet se në emisionin "Pa Gjurmë", transmetuar në televizionin "Report TV", në datën 06 Prill 2023, në orën 16:35 "*Moderatorja njofton live një nënë se vajza e saj ka vdekur, si pa të keq*". Ankuesi tjetër vinte në dukje, "*është e patolerueshme dhe jo etike të shfrytëzohet mediatikisht një ngjarje të tillë*", - dhe sugjeronte "*marrjen e masave ndaj këtij emisioni*".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të trajtimit të ankesës, fillimisht Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive, duke evidentuar, se emisioni përmbante:

- trajtimin e historisë së zhdukjes së një gruaje 22-vjeçare, nënë e një fëmije 5 vjeç, e cila jetonte në Francë, por prej disa muajsh ishte larguar dhe nuk kishte asnjë kontakt me familjen. Pas investigimit nga stafi i emisionit "Pa Gjurmë" ishin zbuluar disa lëvizje të 22-vjeçares nga Franca drejt Italisë dhe më pas drejt Shqipërisë, ku në një aksident në Shkozë, kishte humbur jetën.
- komunikimin e papërshtatshëm *on line* të moderatorës me nënën e viktimës, i cili përmbante hamendësime lidhur me fatin e vajzës së humbur prej muajsh dhe zgjat rreth 10 min (sekuenca në

minutën 16:24 deri në minutën 16:34) duke përfshirë në fund njoftimin - në lidhje direkte - për humbjen e jetës së vajzës, nëpërmjet leximit të mesazhit të një qytetari drejtuar redaksisë së emisionit.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialit, Këshilli i Ankesave konkludoi se komunikimi i mësipërm përbente shkelje të rëndë të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në:

- nenin 4, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", pika 2/ç: "*operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga respektimi dhe garantimi i së drejtës së ruajtjes së jetës private*"
- nenin 33, "Detyrimet e OSHMA-ve", pika 1/dh): "*të mos cenoje të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar nga OSHMA-të dhe mjetet e përdorura për të realizuar këto programe*"
- nenin 46, "Kodi i Transmetimit", pika 2/c: "*OSHMA-të të mos transmetojnë programe që cenojnë rregullat e etikës dhe moralit publik...*", 2/dh: "*OSHMA-të nuk lejohet të shfaqin programe ... që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, përveç rasteve kur sigurohet, duke zgjedhur orarin e transmetimit ose ndonjë masë tjetër teknike, që të*

miturit normalisht nuk i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime...".

si dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, në:

- seksionin 1, pika 1.3: *"OSHMA-të ...respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut.",* pika 1.6: *"respektojnë normat morale dhe etike të shoqërisë, si dhe kërkesat e deontologjisë së profesionit të gazetarit",* seksionin 3, pika 3.1 *"Shpërndarja e informacionit te publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut",* pika **3.3 "OSHMA-të duhet të respektojnë veçanërisht të drejtën e individëve për privatësi kur raportojnë mbi grupet e pambrojtura të popullatës, apo mbi situata kur ka ndodhur ndonjë tragjedi, sëmundje apo shqetësim. Gazetari duhet të shmangë çdo formë ngacmimi, ndërhyrje të lirë apo spekulim që mund të rrisë dhimbjen dhe shqetësimin e atyre që janë përfshirë. OSHMA-të nuk duhet të bëjnë publike identitetin e personave që kanë humbur jetën, apo që janë përfshirë**

nëpër aksidente, përveç rasteve kur OSHMA-të kanë konfirmuar se anëtarët a familjeve të tyre janë informuar dhe janë të vetëdijshëm për situatën.",

- seksionin 4, pika 4.14 *"OSHMA-të duhet të marrin në konsideratë ndjeshmërinë e publikut në rastet e fatkeqësive, katastrofave, aksidenteve, duke u dhënë përparësi operacioneve të shpëtimit dhe mbështetjes.",* seksionin 5, pika 5.31: *"duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve".*

Nga konstatimet e KA, rezultoi se përmbajtja e mësipërme përbënte shkelje të rëndë të Ligjit nr.97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, për më tepër në një format, ku produkti i ka pasur të gjitha mundësitë e evitimit të situatave të tilla të papranueshme si ato të sipërpërmendurat.

Këshilli i Ankesave propozoi vendosjen e sanksionit gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë ndaj subjektit audioviziv "Report TV", masë e miratuar nga Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.Gj	"Top Channel"	"Big Brother"	07.04.2023

1. Objekti i Ankesës

A.Gj i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se "në datën 6 prill 2023 në Televizionin Top Channel pasdite ora 17:15, në emisionin përmbledhës të BBVA, Luisi i ka thënë disa herë "na çave trapin" një personazhi tjetër vip".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave ndërmoi fillimisht verifikimin e kuptimit të fjalës së referuar, e cila sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe (Tiranë 2006), rezulton të ketë këto kuptime:

"TRAP I m.

1. Vija që hap plori, hulli, brazdë; vijë e thellë në tokë; hendek. Trap i thellë. Kapërceu trapin. Mos ec me vrap, se bie në trap. fj. u. Pa hedhur trapin, mos thuaj «hop». fj. u.
2. Përrua i ngushtë dhe i thellë; shtrati i tij. Kaloi trapin.
3. Gropë e thellë në tokë ku futin patatet gjatë dimrit për t'i ruajtur nga të ftohtët;; gropë e madhe. I futën patatet në trap.
4. Vend i ngritur anës një hendeku nga dheu i hedhur, ledh; rrip toke në mes të dy arave,

zakonisht i ngritur dhe i papunuar, që shërben si kufi a për të kaluar; ana e arës që nuk punohet; breg. Trapi i hendekut. Trapi i orës. Ecin (kalojnë) trapeve. Ishte mbushur lumi (hendeku) trap më trap.

5. Udhë e ngushtë në mal a në pyll, shteg; dhiare.

6. krahin. Lehe. Trap me domate (me qepë, me duhan). Trap lulesh.

7. krahin. Pyll i dendur me drurë të shkurtër. Hyri në trap.

8. Bie në trap (në kurth) shih te KURTH,-I. Ku ta nxjerrë trapi të bëhet si të bëhet; të dalë ku të dalë (për një punë, për një çështje etj.).

TRAP II m.

Mjet i thjeshtë lundrimi, i ndërtuar zakonisht me trungje të lehtë ose me dy lundra të vogla, mbi të cilat mbërthehen dërrasa që formojnë një shesh të gjerë; trung druri ose disa dërrasa të lidhura bashkë, me të cilat kalohet një lumë, një liqen etj. Trap i madh. Nget trapin. E kaloi lumin me trap. I ngarkoi në trap."

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, KA konkludoi, se përdorimi i kësaj fjale nuk duket të bjerë ndesh me detyrimet e OSHMA-ve sipas dispozitave në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	"TV Klan"	"Opinion"	07.04.2023

1. Objekti i Ankesës

Dhjetëra ankues iu drejtuan Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se në emisionin "Opinion" transmetuar në televizionin "Klan" në datën 20 Prill 2023, në orën 21:05 ishin "publikuar pamje të rënda për publikun".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave, pasi mori në shqyrtim përmbajtjen audiovizive, evidentoi se:

- në emisionin "Opinion" të datës 20 Prill 2023, me temë diskutimi "*Beteja për Tiranën, Belind Këllici*", gazetari Blendi Fevziu, në orën 21:05:34, pa asnjë paralajmërim etik lidhur me materialin, që do të publikohej si edhe pa përdorur teknologjinë e përshtatshme për mbulimin e pamjeve sensitive, transmeton (*dy herë*) videon e plotë të vrasjes së shtetasit Ardian Nikulaj.
- teksa në ekran shfaqet videoja e vrasjes së A.N, gazetari komenton pamjet me detaje dhe në mënyrë sensacionale "*E qëllon ó herë. Plumbin e fundit në kokë, për të qenë 100% i bindur. Mundohet të mbajë nën kontroll dy personat e tjerë me pistoletë dhe largohet. Është një video tronditëse. Është një video e frikshme në fakt*".

Në përmbushje të detyrimit ligjor, Ligji nr.97/2013, neni 20, pika 2 "*mbikëqyrjen e*

zbatimit të kodeve dhe rregulloreve nga OSHMA-të dhe RTSH", KA/AMA konstatoi gjithashtu se emisioni "Opinion" ishte ritransmetuar edhe në "Klan Plus", në datën 21 Prill 2023, në orën 13:46 së bashku më videon e vrasjes së shtetasit A.N.

Paralelisht më këtë, Këshilli i Ankesave shqyrtoi pamjet filmike të të gjitha OSHMA-ve dhe rezultoi se lajmi mbi vrasjen e shtetasit A.N, deri në momentin e publikimit të videos, ishte shoqëruar me publikimin e fotografisë nga vendngjarja, moment ku shfaqej vrasësi me armën në dorë drejtuar A.N.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në qëndrimin e tij, Këshilli i Ankesave nënvizoi faktin se edhe në rastet kur vendoset se ka një interes publik për transmetimin/publikimin fotos dhe videos kjo duhet shoqërohet me paralajmërim për audiencën dhe mbulim të pamjeve ekstremisht shqetësuese. Gazetarët duhet të mbajnë parasysh kërkesat e ligjit për mediat audiovizive dhe Kodit të Transmetimit mbi etikën dhe gazetarinë e përgjegjshme në çdo moment të kryerjes së punës së tyre.

Këshilli i Ankesave vlerësoi se publikimi i mësipërm përbënte shkelje të rëndë të Ligjit nr.97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në:

- nenin 4, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", pika 1/b: "*Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve*", po

aty pika 2/ç: *"operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga respektimi dhe garantimi i së drejtës së ruajtjes së jetës private"*.

- nenin 33, "Detyrimet e OSHMA-ve", pika 1/ç: *"të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut"*, pika 1/dh): *"të mos cenojë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar nga OSHMA-të dhe mjetet e përdorura për të realizuar këto programe"*.
- nenin 46, "Kodi i Transmetimit", pika 2/dh: *"OSHMA-të nuk lejohet të shfaqin programe ... që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, përveç rasteve kur sigurohet, duke zgjedhur orarin e transmetimit ose ndonjë masë tjetër teknike, që të miturit normalisht nuk i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime..."*.

dhe Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, në:

- seksionin 1, pika 1.3: *"respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut."*, po aty pika 1.6: *"respektojnë normat*

morale dhe etike të shoqërisë , si dhe kërkesat e deontologjisë së profesionit të gazetarit".

- seksionin 3, pika 3.1 *"Shpërndarja e informacionit te publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkaluar të drejtën e privatësisë. Gazetari duhet të sigurohet, për të zbatuar standardet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale."*
- seksionin 5, pika 5.31: *"OSHMA-të... duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve"*.

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave, propozoi vendosjen e sanksionit gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë ndaj subjektit audioviziv "TV KLAN", masë e cila u miratua nga Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizive

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Ankues	"Top Channel"	"Më lër të flas"	19.04.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) iu drejtuan disa ankesa me pretendimin se në emisionin "Më lër të flas" transmetuar në televizionin "Top Channel" në datën 14 Prill 2023, në orën 21:00 përmbajtja audiovizive kishte "gjuhë seksiste" dhe "justifikonte përdhunimin dhe dhunën ndaj grave".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, referuar nenit 51 të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave të televizionit "Top Channel", paraqitjen e pretendimeve në lidhje me ankesat.

Në përgjigjen e vet, Nr.1623/1 Prot. datë 02.05.2023, subjekti audioviziv "Top Channel" bënte me dije se "për shkak të gjuhës së përdorur nga z.Ngjela në emisionin "Më lër të flas" të datës 14 Prill 2023 është marrë si masë

që z.Ngjela të mos jetë më prezent në emision, në asnjë prej puntatave në vazhdim".

Në të njëjtën përgjigje, në vijim sqarohej se "Në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, shoqëria "Top Channel" ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura në respektim të të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit të tyre, duke u distancuar nga qëndrimet personale, sikurse rasti i z.Ngjela".

Edhe nga shqyrtimi i kujdesshëm i emisionit "Më lër të flas", episodi i datës 14 Prill 2023, ora 21:00, me temë "Rritje rekord divorcesh, shkak tradhtia", me panel pjesëmarrës: Zhaklinë Lekatari (Gazetare, Aktiviste); Skenda Halili (Dedektive private); Spartak Ngjela (Avokat) si dhe Armand Peza (Sipërmarrës, organizues eventesh), rezultoi se gjatë diskutimit (ora 21:16:30), deklaratat e avokat Sparta Ngjelës janë kundërshtuar nga të gjithë panelistët e tjerë.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave mbajti në konsideratë reagimin në studio dhe vendimmarrjen e mëpasshme të OSHMA-së, lidhur me rastin, duke konsideruar reagimin e OSHMA-së të mjaftueshëm.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.Th	"Top Channel"	"Big Brother Vip2"	08.05.2023

1. Objekti i Ankesës

E.Th i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, e cila përmbante pretendimet, se: *"në transmetimin e finales së BBV2 në "Top Channel", gjatë ceremonisë kryebashkiaku i uroi çiftit të trashëgohen e "të shtojnë racën e mirë", se: "zbritja nga tarraca e Bashkisë Tiranë kryhej me anë të shkallëve të përdorshme vetëm nga njerëzit që e zotërojnë përdorimin e këmbëve në funksion të të ecurit" dhe se: "gjatë këtij emisioni janë transmetuar vetëm reklama të PS-së për zgjedhjet vendore 2023"*.

2. Administrimi i Ankesës

Nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive, transmetimi i finales së BBV2 në "Top Channel", Këshilli i Ankesave evidentoi se mund të trajtonte vetëm pretendimin e parë, pasi:

- Së pari, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, mënyra e transmetimit të reklamës politike nuk rregullohet nga neni 39 i Ligjit nr.97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, por nga dispozitat e Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, konkretisht në nenet 80 dhe 84 të tij. Për rrjedhojë, shkelja e pretenduar përfshihet në kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe përbën objekt shqyrtimi prej institucionit të KQZ-së.
- Së dyti, Kodi Zgjedhor parashikon specifikime lidhur me minutazhin e lejuar (90 min - pikat 4 dhe 5 të nenit

84) të reklamës politike gjatë fushatës zgjedhore. Në këtë rast, baza ligjore mbi të cilën shqyrtohet pretendimi për transmetim të palejuar të reklamës politike, lidhet kryesisht me vetë subjektin (zgjedhor/garues), për llogari të të cilit ajo transmetohet, prandaj edhe duhet të jetë objekt shqyrtimi prej KQZ.

- Së treti, sipas dispozitave të Metodologjisë së Monitorimit të Mediave gjatë fushatës zgjedhore (miratuar me vendimin nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ), AMA nuk ka kompetenca sanksionuese mbi shkeljet e pretenduara të OSHMA-ve gjatë fushatës, por vetëm të natyrës monitoruese dhe raportuese pranë KQZ.
- Së katërt, aksesueshmëria/përdorimi i mjediseve të godinës së Bashkisë nga PAK, është objekt i Ligjit 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK" dhe jo e Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar apo e Kodit të Transmetimit.

Sa i takonte pretendimit për *"përdorimin e një gjuhe diskriminuese gjatë transmetimit live"*, referuar konkretisht përdorimit të shprehjes *"racë e mirë"*, KA konstatoi sa më poshtë vijon:

- Bazuar në Fjalorin e Gjuhës Shqipe (Tiranë 2006), fjala "racë" ka kuptimet e mëposhtme:

rác/ë,-a emër i gjinisë femërore; numri shumës; -a(t)

1. secili nga grupet e mëdha të shoqërisë njerëzore, me disa tipare të jashtme të trashëgueshme, si ngjyra e lëkurës dhe e flokëve, trajta e kokës etj.: raca e bardhë (e verdhë, e zezë); përzierja e racave.
2. në ligjërimi bisedor; grup njerëzish me një tipar të spikatur: janë racë më vete; / me kuptim keqësues; grup njerëzish me një tipar të keq: racë e keqe.
3. term në zoologji; grup kafshësh, zakonisht shtëpiake, me tipare e cilësi të përbashkëta të trashëgueshme; lloj i zgjedhur kafshësh shtëpiake: racë e pastër (e përzier); racë kuajsh (dhensh); lopë (qen) race; përmirësimi (kryqëzimi) i racës. "diskriminim" është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë ..., që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara

nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. (Ligji 10/2021, ndryshuar me Ligjin 124/2020 - Neni 2).

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, KA konkludoi, se togfjalëshi "racë e mirë" në rastin e referuar nuk ishte përdorur në kuptimin e parë, për të shënuar një "nga grupet e mëdha të shoqërisë njerëzore, me tipare etnike apo antropologjike të ngjashme" por në kuptimin e dytë (ligjërim bisedor), për të shënuar një kategori njerëzish me tipare të spikatura - po dhe këtu jo me kuptim keqësues, çka nuk përbën "diskriminim" në kuptimin e parashikuar prej ligjit (Ligji 10/2021, ndryshuar me Ligjin 124/2020 - Neni 2).

Për rrjedhojë, KA nuk konstatoi shkelje të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017.

Pavarësisht kësaj, Autoriteti i Mediave Audiovizive dëshiron t'ju sigurojë se do të vazhdojë të trajtojë me seriozitet të gjitha ankesat dhe shqetësimet që vijnë për shkelje të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017 si edhe të sensibilizojë të gjithë ofruesit e shërbimeve audiovizive për rëndësinë publike të respektimit të këtyre dispozitave dhe sanksionet ligjore, që burojnë nga shkelja e tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.B	"Top Channel"	"Më lër të flas"	19.05.2023

1. Objekti i Ankesës

Blerjana Bino, drejtore e Organizatës "Shkencë & Inovacion për Zhvillim", i drejtoi një tjetër ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se në emisionin "Më lër të flas" transmetuar në televizionin "Top Channel" në datën 14 Prill 2023, në orën 21:00 përmbajtja audiovizive qarkullonte sërish në kanal zyrtar të OSHMA-së në platformën "YouTube" si dhe në formate të tjera televizive.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadrin e administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave kreu verifikimet e domosdoshme, nga ku rezultoi se OSHMA-ja, nuk kishte hequr përmbajtjen audiovizive nga kanali i saj zyrtar në "YouTube", ndërkohë që e njëjta përmbajtje audiovizive qarkullonte në programacion në forma të tjera. Në vijim të komunikimeve mes Këshillit të Ankesave dhe Bordit të shqyrtimit të ankesave të OSHMA-së, operatorit mediatik audioviziv iu bë me dije se, nga

sinjalizimi i ankuesve, por edhe nga verifikimet, rezultonte se përmbajtja audiovizive ishte e pranishme në kanal zyrtar në Youtube, ndërkohë që ishte transmetuar edhe në formate të tjera televizive.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, KA rikujtoi përgjigjen e OSHMA-së me anë të së cilës bëhej me dije se media *"ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura në respektim të të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit të tyre, duke u distancuar nga qëndrimet personale, sikurse rasti i z.Ngjela"*. Ndaj dhe Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, i kërkoi operatorit mediatik marrjen e masave në respektim të përgjegjësive, me të cilat i ngarkonte Ligji nr.97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit, për të hequr menjëherë nga kanali zyrtar në "YouTube" përmbajtjen audiovizive, me deklaratat e z.Spartak Ngjela në emisionin "Më lër të flas".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
G.Gj	"MCNTV"	"Të Paekspozuarit"	05.06.2023

1. Objekti i Ankesës

Geni Gjyzari, përfaqësues ligjor i shtetasit z.Dhionisios Alfred Beleri, i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave, përmes së cilës pretendonte se në emisionin "Të Paekspozuarit", transmetuar në televizionin "MCN" në datën 25 Maj 2023, në orën 21:00 "është lejuar një gjuhë dhe një fjalor që ka cenuar dinjitetin dhe të drejtat themelore të shtetasit z.Dhionisios Alfred Beleri, me fjalë të tilla si "qen bir qen". Ankuesi pretendonte gjithashtu se në emision "janë dhënë opinione jo të vërteta në lidhje me personalitetin e shtetasit z.Dhionisios Alfred Beleri."

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave iu referua nenit 51 të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", duke kërkuar paraqitjen e pretendimeve të operatorit mediatik.

Pretendimet u paraqitën nga "MCNTV", me shkresën Nr.2056/2 Prot., datë 03.07.2023; ku ndër të tjera thuhej se:

- "Është e paqartë se çfarë shkelje konkrete është konsumuar nga ana e televizionit tonë....pa cituar konkretisht cila e drejtë themelore është cenuar

nga ana jonë apo cilën vepër penale konkrete kemi nxitur.

- MCNTV nuk ka cenuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, përkundrazi i ka respektuar ato.... ka krijuar mundësinë që një person, konkretisht z.Dhuli i ftuar në emision, të shpreh opinionin dhe qëndrimin e tij, siç ai e mendon.
- Dhënia e mundësisë gazetarit Hoxha, që të shprehet, nuk do të thotë që OSHMA "MCNTV", ndan të njëjtin qëndrim apo i miraton opinionet e tij".

Përballë materialit të ankuesit dhe pretendimeve të subjektit audioviziv, Këshilli i Ankesave këqyri me vëmendje episodin e emisionit "Të Paekspozuarit", i transmetuar në "MCNTV" në datën 25 Maj 2023, në orën 21:00, nga ku konstatoi shmangie nga zbatimi i Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në:

- nenin 4, "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", pika 1/b) "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut",
- nenin 46, "Kodi i Transmetimit", pika 2/a) "OSHMA-të të mos transmetojnë programe që cenojnë rregullat e etikës dhe moralit publik",

dhe

- Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë

11.12.2017, në Seksionin 1, "Parimet themelore", në:

- pikën 1.3: "*Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut*".
- pikën 1.5: "*Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin*".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave i solli në vëmendje OSHMA-së zbatimin e Ligjit nr.97/2013 "*Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, në dispozitat e sipërpërmendura, **duke paralajmëruar** se çdo përsëritje do të trajtohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri	"Euronews Albania"	"Goodmorning albanians"	22.06.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Medias Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë nga shoqata fetare "Dëshmitarët e Jehovahit" në Shqipëri, me objekt "*refuzimin e së drejtës së përgjigjes*" lidhur me deklaratat e z.Paulin Vilajeti, i ftuar në emisionin "Goodmorning Albanians", të datës 18 maj 2023, ora 07.40, të cilat cilësohen si "*tronditëse dhe shpifëse ndaj besimit të Dëshmitarëve të Jehovahit*".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, referuar nenit 51 të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv", Këshilli i Ankesave kërkoi nga Bordi i Shqyrtimit të Ankesave pranë televizionit "Euronews Albania" paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e sipërcituar.

Më tej, nisur nga shqyrtimi i përmbajtjes audiovizive përkatëse, KA konstatoi:

- trajtimin e temës "Raporti i DASH për lirinë fetare", me fokus mbështetjen financiare dhe institucionale shtetërore ndaj komuniteteve fetare në Republikën e Shqipërisë,

- diskutimin e temës me disa përfaqësues të komuniteteve fetare në Shqipëri, si: pastori Paulin Vilajeti, At Grigor Palushi, prej Kishës Ortodokse dhe Ylli Gurra, ish-myftiu i Tiranës,
- refuzimin e shoqatës "Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri", për të marrë pjesë në diskutim,

Ndërkohë, në përgjigjen vet, përmes shkresës nr.2402/2prot, të datës 12/07/2023 Ofruesi i Shërbimit Mediatik Audioviziv "Euronews Albania", pretendonte, se:

- *Ftesa për të marrë pjesë në emision "u është drejtuar të gjithë përfaqësuesve të komuniteteve fetare në Shqipëri, përfshirë dhe shoqatën "Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri.*
- *Është komunikuar me përfaqësuesit e shoqatës, të cilët janë përgjigjur, se "nuk dëshironin të merrnin pjesë në emision". Megjithatë, "duke i konsideruar si komunitet fetar në Shqipëri" si edhe në interes të "individëve, të cilët janë pjesë e tij", është "informuar publiku për arësyet e mosprezencës" së përfaqësuesve të shoqatës në televizion.*
- *Ankesa ... u referohet komenteve personale të njërit prej të ftuarve në emision..., ndërsa televizioni nuk atashohet në asnjë moment me këtë qëndrim...*
- *Pas mbërritjes së ankesës, janë marrë të gjitha masat për ta adresuar atë,*

duke komunikuar fillimisht me me përfaqësuesit e shoqatës në rrugë telefonike dhe në vijim edhe nëpërmjet adresës elektronike..., për të kuptuar situatën dhe për gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët. Televizioni i ka ftuar përfaqësuesit e shoqatës përsëri për të shprehur në emision qëndrimin e tyre, por ata kanë refuzuar, duke komunikuar, se nuk kanë pretendim ndaj televizionit, por ndaj qëndrimeve personale të të ftuarit.

- *Euronews Albania ka marrë të gjitha masat për ta zgjidhur çështjen me mirëkuptim, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me përfaqësues të shoqatës, duke i kthyer përgjigje çdo pyetjeje.. si edhe duke iu ofruar kohë televizive për të shprehur qëndrimet dhe shqetësimet e tyre.*

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, duke vlerësuar rolin e medias në trajtimin e temave të tilla me ndjeshmëri dhe impakt në publik si edhe përpjekjen e medias për t'u dhënë zë dhe kohë televizive në mënyrë të barabartë të gjitha subjekteve të interesuara, Këshilli i Ankesave vlerësoi megjithatë, se në këtë kuadër, do të kishte qenë me vend një ndërhyrje e perceptueshme e moderatorëve të emisionit

në shërbim të distancimit të televizionit prej opinionëve të të ftuarit, z.Vilajeti si dhe i risolli në vëmendje detyrimin për respektimin e parimeve themelore të veprimtarisë audiovizive, për të siguruar informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, duke respektuar formimin e lirë të opinionit si edhe duke shmangur promovimin e sjelljeve, që bien ndesh me detyrimet e OSHMA-ve (Ligji nr.97/2013,"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 4, pika 2/ç, d, dh, neni 33, pika 1/b dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, Nr. 60, dt. 10.07.2023, Seksioni 1/pika 1.3, 1.7, 1.9)

Ankuesi, nga ana tjetër, u informua gjithashtu, se, në kushtet, kur:

Ofruesi i Shërbimit Mediatik Audioviziv "Euronews" ka ofruar kohë televizive si edhe **mundësinë e pranisë/shprehjes** në edicionin përkatës, por edhe pas tij, në funksion të ushtrimit të së drejtës së përgjigjes "në mënyrë të ngjashme dhe me kohë të njëjtë me atë të transmetimit objekt ankese" (ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 53/pika 10), **nuk mund të konsiderohet në shkelje pasi nuk ka kryer "refuzim të së drejtës së përgjigjes"** (Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 53/pika 7).

2

Ankesa me objekt

"cenimin e të drejtave

të fëmijëve"

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
ASHDM	"Top Channel"	"Big Brother Vip2"	20.01.2023

1. Objekti i Ankesës

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës përmes një shkrese dërguar Këshillit të Ankesave pranë AMA-s shprehu shqetësimin e saj lidhur me deklarime tepër të rënda të transmetuara në Reality Show "Big Brother" në Top Channel.

Sipas ASHDM dy nga personazhet e këtij formati "*në mënyrë të paprecedente gjatë një bisede mes tyre, kanë cenuar rëndë të drejtat dhe sigurinë e fëmijëve*", pasi gjatë bisedës ishin hamendësuar në formë shakaje veprime kriminale të dhunshme, të rrezikshme shumë të rënda ndaj fëmijëve, çka kishte shkaktuar reagim tek publiku, i shqetësuar prej këtyre deklaratave të rënda.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim përmbajtjen audiovizive përkatëse nga ku rezultoi se materiali i mësipërm:

- nuk ishte transmetuar në PRIME, siç pretendohet,
- nuk ishte transmetuar as në përmbledhjet ditore të BBA, pra nuk ishte transmetuar fare në TOP Channel,
- ishte transmetuar vetëm në kanalet e dedikuara Big Brother VIP Albania 1 & 2, të cilat nuk janë të hapura për publikun e gjerë, duke mundësuar për rrjedhojë kontrollin e prindit ndaj ekspozimit të fëmijës në raport me to,
- justifikimit publik të produksionit me "situatën e lojës", që erdhi si reagim

pas shqetësimit të publikut për episodin, iu shtua edhe ndjesa publike e vetë personazhit (Amos Zaharia - https://www.instagram.com/amos_mujizaharia),

- videoja nuk ishte e pranishme në faqen zyrtare të Top Channel.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në rrethanat e sipërpërmendura, kur, përveç sqarimit publik të produksionit dhe protagonisistit lidhur me episodin, përmbajtja audiovizive as ishte transmetuar dhe as ishte e pranishme në anjë prej llogarive online të OSHMA-së,

Këshilli i Ankesave, pasi konstatoi, se

- videoja qarkullonte në internet vetëm nëpër portale, një prej të cilëve edhe ai, të cilit i referohej agjencia

konkluoi, se

- në kushtet, kur videoja nuk ishte e pranishme në faqen zyrtare të "Top Channel", "dëmin" si pasojë e përhapjes në Internet e "shkaktonin" portalet dhe jo OSHMA-ja.

Pavarësisht kësaj, referuar ligjit të vet organik dhe dispozitave që rrjedhin prej tij, Këshilli i Ankesave, si pjesë integrale e Autoritetit të Mediave Audiovizive i bëri me dije ankuesit, ASHDM –së, se e ka formatin e sipërpërmendur në vëzhgim dhe pikërisht më dt. 17.01.2023 i ka tërhequr vëmendje OSHMA-së për shkelje të Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (neni 33) nga ana e të njëjtit personazh të formatit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.D	Radio Club Fm	Programi "Mix"	09.03.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi A.D me pretendimin se *"programi "Mix", transmetuar në radion kombëtare "Club FM", më datë 03 Mars 2023, në orën 19:45, përmbante "fjalor joetik", pasi "i ftuari i ditës kishte përdorur një shprehje joetike, e cila përmban fjalën "trap".*

2. Administrimi dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës së shtetasit A.D, KA ndërmoi verifikimin e kuptimit të fjalës, e cila sipas Fjalorit të gjuhës shqipe (Tiranë 2006), nuk rezultonte të kishte përdorime joetike ose fyese.

Për sa më sipër, KA/AMA nuk gjeti argumentime ligjore në mbështetje të pretendimit të ankuesit.

Pavarësisht kësaj, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive e siguroi ankuesin se do të vazhdojë të trajtojë me seriozitet të gjitha ankesat dhe shqetësimet që vijnë për shkelje të Ligjit Nr. 97/ 2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017 si edhe të sensibilizojë të gjithë ofruesit e shërbimeve audiovizive për rëndësinë publike të respektimit të këtyre dispozitave dhe sanksionet ligjore, që burojnë nga shkelja e tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.B	"Abc News"	"Zonë e Lirë"	15.05.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë, përmes së cilës pretendohet se në emisionin "Zonë e lirë" transmetuar në televizionin "Abc News" në datën 12 Maj 2023, në orën 21:00, "... gazetari filloi të mbante qëndrime fyese dhe poshtëruese ndaj shqiptarëve, duke bërë shenja të turpshme me duar si dhe duke folur përçart".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave, pasi mori në shqyrtim përmbajtjen audiovizive, evidentoi se:

- Në episodin përkatës diskutohet mbi "Arrestimin e kandidatit Beleri dy ditë para zgjedhjeve", me penalistët z. Arian Curri, z.Illir Kulla, z.Ervin Karamuço dhe me praninë online të z.Vangjel Dule.
- Drejtuesi i emisionit, z.Arian Çani në editorialin e tij, teksa fliste mbi ngjarjen e fundit nga aktualiteti, arrestimin e kandidatit për kryetar bashkie në Himarë, z.Fredi Beleri, ka bërë një gjest fyës, i cili përsëritet tre herë brenda pak minutash.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vlerësoi se pamje e tillë (gjesti fyës) transmetuar në një orar të papërshtatshëm (ora 21:04:53; 21:05:06; 21:05:25) ishte në shkelje të Ligjit Nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në:

- nenin 33, "Detyrimet e OSHMA-ve", pika 1/d: "të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik...".
- nenin 46, "Kodi i Transmetimit", pika 2/c: "OSHMA-të të mos transmetojnë programe, që cenojnë rregullat e etikës dhe moralit publik..." .

dhe Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, në:

- seksionin 1, pika 1.6: "respektojnë normat morale dhe etike të shoqërisë",
- seksionin 5, pika 5.31: "OSHMA-të të duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve", pika 5.34: "duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. (Ora kufi 22.00 - 06.00)".

Këshilli i Ankesave vlerësoi se:

- provokimi i shikuesve me një gjest të tillë, nuk është qasja e duhur për një subjekt audioviziv që ka në përdorim një frekuencë, aset publik.
- pluraliteti, diversiteti dhe debati i lirë gjatë komunikimit në studion televizive, nuk ka asgjë të përbashkët me përçmimin verbal apo gjestikulativ.
- evitimi i qasjeve të tilla nuk përbën censurë, por përgjegjësi profesionale

dhe etike ndaj publikut dhe interesave të tij.

Duke theksuar se emisioni transmetohej në një orar që ndiqet edhe nga të mitur, Këshilli i

Ankesave i propozoi Autoritetit të Mediave Audiovizive vendosjen e sanksionit gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë ndaj subjektit audioviziv "Abc News", masë e cila u miratua.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
ASHMDF	"Syri TV"	Edicion informativ	16.06.2023

1. Objekti i Ankesës

Përfaqësues të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve i nisën Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me pretendimin se në "Syri TV", në datën 16 Qershor 2023, ora 12:42 ishin "... transmetuar pamje krejtësisht të papërshtatshme për ... fëmijët".

2. Administrimi i Ankesës

Nga shqyrtimi i materialeve të referuara u evidentua se:

- Në "Syri TV" ishte transmetuar në 16 Qershor 2023, në orën 12:42; në rubrikën "Breaking News" materiali me titull: Video skandaloze/Kryebashkiaku i Kukësit Safet Gjici marrëdhënie seksuale në zyrën e Bashkisë.
- Nga moderatorja shpjegohej përmbajtja e materialit audiovizive: "Është një video skandaloze që ka qarkulluar në rrjetet sociale, e publikuar fillimisht në "Telegram". Bëhet fjalë për kryetarin e Bashkisë së Kukësit i dalë nga zgjedhjet e 14 Majit, i cili duket qartë në një video të publikuar së bashku me një vajzë duke kryer veprime të turpshme seksuale. Këto janë edhe pamje që vijnë nga zyra e Kryetarit të bashkisë së Kukësit, Safet Gjici i cili në këtë video duket qartazi se është duke kryer marrëdhënie seksuale në zyrën e bashkisë.....".

- *Materiali audioviziv në fjalë transmetohet disa herë, shoqëruar edhe me komentën e moderatores, teksa kjo e fundit nuk bën paralajmërime apo thirrje shikuesve në lidhje me materialin që po shfaqej në televizion apo marrjen e masave për mbrojtjen e të miturve, ndaj efekteve që përmbajtje e tillë mund të shkaktojë tek ta.*

Autoriteti i Mediave Audiovizive konstatoi se transmetimi i përmbajtjes audiovizive "Video skandaloze/Kryebashkiaku i Kukësit Safet Gjici marrëdhënie seksuale në zyrën e Bashkisë", shmang detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në:

- **nenin 46, "Kodi i Transmetimit", pika 2/dh):** "në çështjet që përfshijnë moralin dhe etikën në materialet programore, veçanërisht paraqitja e sjelljeve të dhunshme dhe seksuale të realizohet me kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të të miturve. OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor, ose moral të të miturve, në veçanti programe që përmbajnë pornografi ose që paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale. OSHMA-

të nuk lejohet të shfaqin programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, përveç rasteve kur sigurohet, duke zgjedhur orarin e transmetimit ose ndonjë masë tjetër teknike, që të miturit normalisht nuk i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. Kur programe të tilla transmetohen në formë të hapur ato duhet të paraprihen nga një paralajmërim akustik ose të identifikohen nga prezenca e një simboli viziv gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre".

dhe

Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, në:

- **seksionin 1, pika 1.1:** "*OSHMA-të ... garantojnë e respektojnë lirinë dhe të drejtat e njeriut*", **pika 1.3:** "*respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut*", **pika 1.4:** "*mbrojnë të drejtat, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*", **pika 1.6:** "*respektojnë normat morale dhe etike të shoqërisë*", **pika 1.13:** transmetimet me "*elementë të dhunës së skajshme ...u nënshtrohen rregullave të veçanta të një sistemi kontrolli, si ai i aksesit të kushtëzuar apo programeve të kriptuara*", **pika 1.16:** "*promovojnë dhe mbrojnë mirëqenien,*

shëndetin e zhvillimin harmonik moral e fizik të fëmijëve".

- seksionin 5, **pika 5.30:** "*OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor, ose moral të fëmijëve, në veçanti filma apo programe që ... paraqesin skena dhune të skajshme*", **pika 5.31:** "*duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve*", **pika 5.34:** "*duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. (Ora kufi 22.00 - 06.00)*", **pika 5.44:** "*për programet që transmetohen në fashën orare 19.00 – 22.00, bëhet i detyrueshëm përdorimi i shenjave paralajmëruese për programet që cenojnë e dëmtojnë fëmijët*".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij Autoriteti i Mediave Audiovizive i tërhoqi vëmendjen OSHMA-së "Syri TV" për shmangie të zbatimit të Ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, si dhe i rikujtoi, se përsëritja e shkeljeve të ngjashme do të penalizohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.M	-	-	23.06.2023

1. Objekti i Ankesës

E.M i drejtoi një shkresë të dytë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, ku njoftonte se po trajtonte ankesën e saj pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave me marrjen e shkresës në fjalë konstatoi, se ankesës i mungonin elementët e domosdoshëm, që bënë të mundur administrimin e saj.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në këto kushte, Këshilli i Ankesave sqaroi ankuesen, ndër të tjera, se "*kërkesa për të specifikuar median, formatin, datën dhe orën e saktë të përmbajtjes audiovizive, objekt të ankesës, përbën parakusht për administrimin e ankesës dhe adresimin e saktë të përgjegjësisë për shkëljen e pretenduar*".

Ankueses iu bë me dije se "*Në kushtet, kur të dhënat e sipërcituara mungojnë, Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mungon baza ligjore për hetimin*

e shkëljes dhe përcaktimin e përgjegjësive të lidhura me të, duke e bërë të pamundur administrimin e ankesës sipas dispozitave ligjore në fuqi".

Përtej administrimit të ankesës dhe procedurave të lidhura me të, Këshilli i Ankesave informoi, se kujdet vazhdimisht për sensibilizimin e Ofruesve të Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) në drejtim të përmbushjes së detyrimeve të tyre ligjore, nëpërmjet:

- *nismave ligjore për plotësimin e dispozitave në mbrojtje të të drejtave të njeriut, veçanërisht atyre të fëmijëve*
- *rishikimin e akteve nënligjore, si kode, rregullore dhe udhëzime, në dispozitat përkitazi të drejtat e njeriut, veçanërisht atyre të fëmijëve*
- *hartimin e Kodit të Ri të Transmetimit, duke u fokusuar më shumë dhe më fort te mbrojtja e të dhënave personale dhe të drejtat e fëmijëve*
- *konsultimeve publike*
- *thirrjeve sensibilizuese*

dhe se çdo informacion relevant publikohet edhe në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive në internet dhe në rrjetet sociale.

3

Komunikime tregtare

të ndaluar

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.Ç	Disa OSHMA	KomunikimTregtar	07.02.2023

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi E.Ç me pretendimin se, disa operatorë audiovizivë kishin transmetuar një komunikim tregtar, me objekt vezën Rea, ku *"...një shtatzënë konsumonte një vezë të pagatuar mirë (pothuajse të gjallë)"* çka nga këndvështrimi ankuesit shihej problematike, pasi *"... për gratë shtatzënë ajo nuk është e këshillueshme (prej rrezikut të sallmonella-s...)*. Ankuesi ngrinte shqetësimin, se *"reklama jepte një informacion të gabuar"*, pasi *"gratë shtatzëna pa njohurinë e duhur apo pa një ndjekje gjinekologjike mund të keqinformoheshin"*.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të trajtimit të ankesës, fillimisht Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive ku konstatoi, se reklama e vezës Rea kishte në fokus konsumin e saj nga një grua shtatzënë...

Në vijim, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive iu drejtua me një *"Kërkesë për mendim të kualifikuar lidhur me një komunikim tregtar të transmetuar nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv"*, Nr.1130 Prot., datë 03.03.2023, Autoritetit

Kombëtar të Ushqimit si dhe Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit.

Në përgjigjen e vet, Nr.1266/1, Prot., datë 21.03.2023, protokolluar me tonën me Nr.1130/1 Prot., datë 27.03.2023, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Drejtoria e Përgjithshme vë në dukje se:

"Shqipëria listohet në vendet të cilat mund të eksportojnë vezë drejt BE-së dhe se stabilimenti "Rea's është njëri prej tyre. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në zbatim të planit të kontrolleve zyrtare inspekton çdo muaj këtë subjekt duke marrë mostra për analizimin e treguesve mikrobiologjikë si "sallmonella", etj. Sipas të dhënave që disponojmë rezulton se nuk ka pasur jokonformitete nga analizimi i produktit vezë të këtij stabilimenti".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, duke qenë se ekspertët e fushës e përjashtuan rrezikshmërinë e produktit, të cilit i bëhej reklamë, për konsumatorët, Këshilli i Ankesave, për rrjedhojë, nuk konstatoi as shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017.

4

Ankesa jashtë objektit

të veprimtarisë

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.SH	Disa portale	-	06.02.2023

1. Objekti i Ankesës

L.Sh i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me një lajm të publikuar nga portalet "Fax.al, Botasot.info, Arkivalajmeve.com, Gazeta-Shqip.com, Telegrafi.al". Ankuesja kërkonte heqjen e emrit të saj nga këto portale bazuar në vendimin e gjykatës, që e kishte shpallur të "pafajshme".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialit të referuar nga ankuesja, u evidentua se publikimi i përmbajtjes audiovizive ishte bërë në mediat

online (portale), gjë e cila del jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar nenit 2, "Fusha zbatimit" të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre."

Në zbatim të dispozitës ligjore të sipërpërmendur, ankueses iu sqarua se publikimi në mediat online, shtypin e shkruar dhe rrjetet sociale bie jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Për rrjedhojë administrimi i ankesës përkatëse ishte jashtë objektit të veprimtarisë dhe kompetencave të këtij Autoriteti."

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.G	Top Channel	-	27.02.2023

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja A.G i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive, me anë të së cilës kërkonte që "televizioni "Top Channel" të filmojë shtëpinë e dëmtuar nga tërmeti. Sepse asnjë organ ekzekutiv nuk kishte ardhur".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, duke mirëkuptuar ndjeshmërinë dhe shqetësimin e shprehur në

të, Këshilli i Ankesave e informoi ankuesen, se kërkesa për filmim nga televizionet është jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionon se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre.....", pra "pas" dhe "para" transmetimit në media.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.L dhe E.Xh	Top Channel	"BBVA" "Përputhen"	03.03.2023

1. Objekti i Ankesës

Shtetasit A.L dhe E.Xh, përfaqësues të Pakicave Rome dhe Egjiptiane në Komitetin për Pakicat Kombëtare i drejtuan një ankesë Këshillit të Ankesave pranë AMA-s në lidhje me disa video të transmetuara nga "Top Chanel", (BBVA ose Përputhen), të cilat më pas u bënë virale në rrjetet sociale si "Tik Tok", "Facebook", etj. Sipas ankuesve është e disata herë, që produksionet e promovojnë gjuhën e urrejtjes, respektivisht ndaj Pakicave Kombëtare Rome dhe Egjiptiane.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshilli të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi mori në shqyrtim ankesën duke vlerësuar maksimalisht ndjeshmërinë e ankuesve lidhur me publikimin, i informoi ata se publikimi në mediat online është jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar Ligjit nr.

97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionohet se *"Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre."*

Këshilli i Ankesave sqaroi gjithashtu, se bazuar në rregulloret përkatëse, shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të nenit 33 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në bazë të një formulari ankesë i cili kërkon saktësimin e përmbajtjes audiovizive, subjektit, ku është transmetuar materiali, si dhe datën dhe orën e saktë të transmetimit të tij.

Sa më sipër, KA u kërkoi ankuesve të specifikonin saktësisht programin, datën dhe orën e saktë të transmetimit ndaj të cilit ankoheshin!"

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.G	-	-	04.04.2023

1. Objekti i Ankesës

A.G i drejtoi një shkresë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se ishte zhgënjyer në pritshmëritë e veta ndaj abonimit në kompaninë "Vodafone"- sipas saj, -"nën pronësinë e AMA-s...sipas të gjitha ligjeve të shtetit".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialeve të referuara nga ankuesja, Këshilli i Ankesave evidentoi faktin që vijimi i trajtimit të ankesës dilte jashtë objektit të veprimtarisë dhe kompetencave Autoritetit sipas Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i

ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", sanksionon se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre.....".

Në zbatim të dispozitës ligjore të sipërpërmendur, Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankueses se shqyrton vetëm materiale të cilat i referohen transmetimit të përmbajtjeve audiovizive, që përmbajnë shkelje të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bazuar në një formular ankese, i cili kërkon të dhëna të sakta për subjektin audioviziv, ku është transmetuar materiali, datën dhe orën e transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.T	InfoShqip	Shkrim	07.04.2023

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi E.T i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive, me pretendimin se "portale përdorindezinformim por dhe fjalorin e papërshtatshëm", duke iu referuar një lajmi me titull "O Luvi po sa cm e ke ti", Kiara qenka kurioze e madhe, e pyet sa centimetra e ka!...", e publikuar nga portali "Infoshqip".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi, se materialet e referuara nga ankuesi ishin publikuar në mediat online, çka e nxirrte çështjen jashtë objektit të veprimtarisë

dhe kompetencave të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", përcakton se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre."

Në vijim, Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankuesit, se u referohej përmbajtjeve jashtë veprimit të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke sqaruar se ankesa paraqitet, duke plotësuar formularin orientues, i cili kërkon të dhëna të sakta për subjektin audioviziv ku është transmetuar materiali, datën dhe orën e saktë të transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F.Sh	Internet	Video	24.04.2023

1. Objekti i Ankesës

F.Sh i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave me pretendimin se *"pas videos që po qarkullon në internet i një personazhi televiziv dhe me influencë, personazhi në fjalë Megi Pojani, moderatore e një emisioni "Fan Club" pranë "Top Channel" ...duhej të hiqte dorë nga drejtimi i atij emisioni, dhe të mos i jepej më e drejta, të moderonte asnjë emision tjetër, për shkak të ndikimit negativ te teleshikuesit"*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialit të referuar nga ankuesja, u evidentua se kërkesa ishte jashtë objektit të veprimtarisë dhe kompetencave të

Autoritetit të Mediave Audiovizive. Referuar Ligjit nr. 97/2013, *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", përcakton se *"Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre....."*.

Në vijim, Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankuesit, se u referohej përmbajtjeve jashtë veprimit të Ligjit nr. 97/2013, *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, duke sqaruar se ankesa paraqitet, duke plotësuar formularin orientues, i cili kërkon të dhëna të sakta për subjektin audioviziv ku është transmetuar materiali, datën dhe orën e saktë të transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.I	"YouTube"	Video	15.05.2023

1. Objekti i Ankesës

D.I iu drejtua Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive me një ankesë, e cila përmbante pretendimin se në transmetimin e subjektit audioviziv "TV Klan", (<https://www.youtube.com/watch?v=Y3RoxOd9fg&t=8s>) ishte cituar *"emri i plotë dhe mbiemri i K.B, ... si shpërndarës i lëndëve narkotike, i ndaluar nga policia. Publikimi ishte në shkelje të prezumimit të pafajësisë ..."*. Ankuesja kërkonte marrjen e masave për heqjen e publikimit të linkut të sipërcituar,

bazuar në të drejtën për ruajtjen e të dhënave personale.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës, e informoi ankuesen, se linku i referuar prej saj ["https://www.youtube.com/watch?v=Y3RoxOd9fg&t=8s"](https://www.youtube.com/watch?v=Y3RoxOd9fg&t=8s), përmbante një video, e cila nuk ishte më e disponueshme.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.I	"YouTube"	Video	19.05.2023

1. Objekti i Ankesës

D.I i drejtoi një ankesë të dytë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive ku ridërgoi linqet e publikuara në kanal zyrtar në "YouTube" të subjektit audioviziv "TV Klan", prej nga ku kërkonte marrjen e masave për heqjen e publikimit të tyre.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialit të referuar nga ankuesja, u evidentua se publikimi i përmbajtjes audiovizive ishte bërë në mediat

online (portale) dhe, për rrjedhojë, ishte jashtë objektit të veprimtarisë dhe kompetencave të Autoritetit të Mediave Audiovizive, referuar nenit 2, "Fusha zbatimit" të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ankueses iu sqarua më tej, se për administrimin e ankesës dhe komunikimin me Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv, duhen të dhëna të sakta për transmetimin e përmbajtjes audiovizive përkatëse, e cila ka shërbyer si burim për publikimin e referuar në YouTube. Sa më sipër, ankueses iu kërkua plotësimi i elementëve të ankesës, (subjekti, data dhe ora) e transmetimit të përmbajtjes audiovizive (kronikës informative).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Aleanca LGBT	Portali "JOQ"	Foto	29.05.2023

1. Objekti i Ankesës

Aleanca LGBT i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se portali "JOQ" postonte "*lajme diskriminuese dhe stigmatizuese që targetonin vajzat e komunitetit transgjinnor duke nxjerrë foto dhe detaje të tjera private, si adresa e shtëpisë, të cilat i identifikojnë lehtësisht dhe i vendosin në rrezik për jetën*".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përgjigje të shqetësimit iu bë me dije ankuesve se "Neni 2 i Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në RSH", i ndryshuar, parashikon si fushë zbatimi të ligjit, e njëkohësisht, të aktivitetit rregullator të AMA-s, si institucion i cili vepron në zbatim të tij, vetëm transmetimet audio dhe audiovizive. Gjithashtu, sipas përditësimit më të fundit të Ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar, nëpërmjet Ligjit nr. 30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", konkretisht nenit 2/8 të Ligjit nr. 30/2023, specifikohet në mënyrë shterruese

koncepti i platformave, mbi të cilat do të veprojë kuadri ligjor dhe nënligjor, që do të jenë objekt monitorimi i AMA-s. Neni detajon rregullimin e platformave në të cilat publikohen video nga përdoruesit, për të cilat platforma nuk ka përgjegjësi editoriale: "*Shërbimi i platformës së shpërndarjes së videove*" nënkupton një shërbim, qëllimi kryesor i të cilit ose i një pjese të shkëputur të tij, apo një funksion thelbësor i shërbimit është ofrimi për publikun e gjerë të programeve, videove të krijuara nga përdoruesi ose të dyjave së bashku, me qëllim informimin, argëtimin ose edukimin nëpërmjet një rrjeti të komunikimeve elektronike për të cilat ofruesi i platformës së shpërndarjes së videove nuk ka përgjegjësi editoriale, dhe organizimi i të cilës, përfshirë përdorimin e mjeteve automatike ose algoritmet në veçanti për shfaqjen, etiketimin dhe renditjen, përcaktohet nga vetë ofruesi i platformës së shpërndarjes së videove. Sidoqoftë, kuadri nënligjor për platformat e shpërndarjes së videove, objekt i ligjit nr. 30/2023 është aktualisht në proces hartimi nga AMA dhe amendimet nuk kanë hyrë ende në fuqi. Ndaj për gjithë sa më sipër, iu bë me dije se objekti i kërkesës së subjektit të interesuar, nuk hyn në kompetencat rregullatore të AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F.N	Prapaskena Boldnews Pamfleti	Shkrime	23.06.2023

1. Objekti i Ankesës

F.N. i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se "në websitet,

"Pamfleti", "Boldnews" dhe "Prapaskena" ishin publikuar shkrime me informacione të rreme të cilat cenojnë nderin dhe dinjitetin".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialeve të referuara nga ankuesja, Këshilli i Ankesave konstatoi se trajtimi i ankesës ishte jashtë fushës së veprimit dhe kompetencave të Autoritetit, të përcaktuara prej Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "Fusha e zbatimit", e të cilit sanksionon, se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre.....".

Në zbatim të dispozitës ligjore të sipërpërmendur, Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankueses se shqyrton vetëm ankesa, të cilat i referohen transmetimit të përmbajtjeve audiovizive, që përmbajnë shkelje të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Këshilli i Ankesave sqaroi më tej, se edhe Ligji nr.30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë e Shqipërisë", të ndryshuar, miratuar në datën 13.04.2023 nuk e prek veprimtarinë e portaleve online.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.B	Prapaskena	Shkrime	26.06.2023

1. Objekti i Ankesës

A.B i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se portali "Prapaskena.com" "ka publikuar të dhëna të pavërteta, denigruese, fyese dhe shpifëse ndaj meje".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i materialeve të referuara nga ankuesja, Këshilli i Ankesave konstatoi se trajtimi i ankesës ishte jashtë fushës së veprimit dhe kompetencave të Autoritetit, të përcaktuara prej Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2,

"Fusha e zbatimit", e të cilit sanksionon, se "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre.....".

Në zbatim të dispozitës ligjore të sipërpërmendur, Këshilli i Ankesave i bëri me dije ankueses se shqyrton vetëm ankesa, të cilat i referohen transmetimit të përmbajtjeve audiovizive, që përmbajnë shkelje të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Këshilli i Ankesave sqaroi më tej, se edhe Ligji nr.30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë e Shqipërisë", të ndryshuar, miratuar në datën 13.04.2023 nuk e prek veprimtarinë e portaleve online.

5

Ankesa me objekt të
ndryshëm & Kërkesa
për informacion

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.GJ	TV Klan TOP Channel	BBVA, Për'puthen Zemërluana	13.02.2023

1. Objekti i Ankesës

A.GJ iu drejtua Autoritetit të Mediave Audiovizive, duke u ankuar për:

- dëmtimin e interesave të moshave të mitura gjatë transmetimeve, kryesisht direkte, në televizionet "Top Channel" dhe "TV Klan", në emisionet BBVA, "Për'puthen" dhe emisionin e Luana Vjollcës*

si edhe duke kërkuar llogari, për:

- moskontrollimin /moscensurimin e këtyre emisioneve nga ana e AMA-s*
- gjobitjen apo mosgjobitjen e tyre për parregullsi në fjalor dhe moszbatim të etikës televizive, mbështetur në ligjet në fuqi*
- Arsyen e mosfunksionimit të websit-it të Autoritetit*

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përgjigje të shkresës nr.799 Prot., protokolluar më datë 13.02.2023, me anë të së cilës ankuesi, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" si dhe Ligjin nr.107/2021 "Për bashkëqeverisjen", Këshilli i Ankesave pranë AMA-s u përgjigj si vijon:

- Autoriteti i Mediave Audiovizive është organizmi rregullator për fushën e mediave audiovizive, në bazë të Ligjit

nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nga i cili rrjedh edhe Kodi i Transmetimit. Në 17 Janar 2023, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, kishte ndërmarrë një verifikim, prej të cilit rezultoi, se në kanalën me pagesë "Big Brother Vip 1", ishte zhvilluar një bisedë mes banorëve, e cila rezultoi me shkelje të rënda etike. Menjëherë pas evidentimit dhe verifikimit të përmbajtjes, referuar Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (neni 4 pika 2/d dhe dh, neni 32, pika 4, neni 33 pika 1/ç dhe d) si dhe të Kodit e Transmetimit, miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 228, datë 11.12.2017, (Seksioni 1, pika 1.5 dhe 1.6), Këshilli i Ankesave pranë AMA-s përmes shkresës nr.277/1 prot, datë 18.01.2023 i tërhoqi vëmendjen operatorit audioviziv "Top Channel" në lidhje me shkeljet e mësipërme. Më 2 Shkurt 2023, Autoriteti i Mediave Audiovizive ndëshkoi "TV Top Channel" me gjobë në masën 200,000 (dyqindmijë) lekë", për shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit miratuar me vendimin nr. 228, datë 11.12.2017, të AMA-s, emisionin "Për'puthen", episodin e datës 14 Dhjetor 2022.

- Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni, Autoriteti i

Mediave Audiovizive ushtron funksionet e veta, bazuar në legjislacion, konkretisht neni 19 pika 3 dhe 4, përcaktojnë se *"AMA kontrollon zbatimin e këtij ligji nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën objekt të këtij ligji dhe, në rast shkeljesh, vendos sanksione"*, si dhe *"monitoron tërësinë e programeve të transmetuara nga OSHMA-të"*. Prej muajit prill 2016, pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive funksionon Këshilli i Ankesave, sipas kërkesave të Ligjit nr.97/2013 *"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar. Neni 20, pika 2 i këtij ligji përcakton objektin e punës së Këshillit të Ankesave, si: *"...mbikëqyrje e zbatimit të Kodit (të Transmetimit) dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë sidomos me respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normale morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive"*.

3. Autoriteti në komunikimin e vet me Operatorët e Shërbimit Mediatik Audioviziv, si dhe në procesin e vendimmarrjeve ureferohet vetëm kërkesave të Ligjit nr.97/2013, i ndryshuar, Kodit të Transmetimit, si dhe gjithë akteve të tjera nënligjore në fuqi. Çfarë do të transmetojë një

OSHMA dhe në cilin orar, kjo është një e drejtë e subjektit audioviziv të licencuar ta përcaktojë, pasi vetëm subjekti e mban linjën editoriale për përmbajtjet audiovizive të transmetuara. Neni 4 i këtij ligji, në seksionin "Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive", pika 1/a) përcakton se *"veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë"*. Po aty, pika 1/b), saktëson gjithashtu se *"veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve"*.

4. Rastet e përmbajtjeve konkrete të papërshtatshme dhe në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi, AMA i shqyrton dhe i vlerëson bazuar po në kërkesat e këtij legjislacioni, duke garantuar lirinë në veprimtarinë audiovizive si dhe mosdërhyrjen në linjën editoriale të redaksive.
5. Faqja zyrtare e Autoritetit të Mediave Audiovizive është funksionale. Asaj mund t'i drejtohet gjithkush në adresën ama.gov.al.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.GJ	TV Klan TOP Channel	Për'puthen Zemërluana Në kurthin e Piter Panit	01.03.2023

1. Objekti i Ankesës

A.GJ iu drejtua Autoritetit të Mediave Audiovizive, duke përsëritur ankesën paraardhëse, me objekt:

- dëmtimin e interesave të moshave të mitura gjatë transmetimeve, kryesisht direkte, në televizionet "Top Channel" dhe "TV Klan", në emisionet "Për'puthen", "Në kurthin e Piter Panit" dhe emisionin e Luana Vjollcës*

si edhe duke kërkuar llogari, për:

- mënyrën e kontrollimit teknik të këtyre emisioneve nga ana e AMA-s*
- moscensurimin e këtyre emisioneve nga ana e AMA-s*
- gjykitjen apo mosgjykitjen e tyre për parregullsi në fjalor dhe moszbatim të etikës televizive, mbështetur në ligjet në fuqi*
- kompetencat e AMA-s për kontrollin e kanaleve kabllore apo paketave digjitale të Tring apo Dixhitale dhe detyrimin e tyre për të vendosur në to kanalet kombëtare, si TVSH, Top Channel, Klan Vizion Plus.*
- kompetencat e AMA-s për t'i detyruar kanalet televizive, që të vendosin emërtimet e emisioneve në gjuhën shqipe (pasi shumiva u vendosin atyre emra anglisht, (top story, top talk etj).*

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vijim të komunikimit, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s iu përgjigj pretendimeve shtesë të ankuesit, si vijon :

- Monitorimi dhe shqyrtimi i përmbajtjeve të transmetuara audiovizive bazohet në kërkesat e Ligjit 97/2013, i ndryshuar, në kërkesat e Kodit të Transmetimit, si edhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Dy janë qasjet e AMA-s për shqyrtimin e përmbajtjeve të transmetuara: duke monitoruar kryesisht –ex officio, apo duke shqyrtuar ankesat e publikut.
- Përkitazi kërkesës/ankesës për kanalet kabllore apo digjitale Këshilli i Ankesave informoi se në nenin 87 të Ligjit organik nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet se: "1. AMA ka të drejtë t'u vendosë OSHMA-ve detyrime të arsyeshme për transmetimin e një ose më shumë programeve audio dhe audiovizive me interes të përgjithshëm për publikun, me qëllim marrjen e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë në nivel kombëtar, rajonal ose lokal. 2. Detyrimet e mbartjes, sipas pikës 1 të këtij neni, imponohen në përputhje me

parimet e proporcionalitetit dhe transparencës, vetëm ndaj operatorëve të komunikimeve elektronike, rrjetet e të cilëve shfrytëzohen nga një numër i konsiderueshëm përdoruesish, si mjet kryesor për marrjen e programeve audiovizive, dhe vetëm nëse kjo është në interes të publikut". Në zbatim të parashikimit ligjor të sipërcituar, AMA me vendimin nr. 4, datë 26.03.2014, ka miratuar detyrimin e mbartjes së programeve të televizioneve kombëtare "TVSH", "TV Klan", "TV Top Channel", nga ana e subjekteve kabllore të licencuar/autorizuar për zonat që nuk mbulohen me sinjal nga ofruesit e shërbimit të programit kombëtar audioviziv. Ndërkohë Gjykata Administrative e Apelit, pas investimit gjyqësor nga shoqëria "Top Channel" sh.a., dhe "Tv Klan" sh.a., ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë, Tiranë, e cila ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 4, datë 26.03.2014 të AMA-s.

Këshilli i Ankesave sqaroi gjithashtu, se edhe në projektligjin "Për disa

shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën Shqipërisë", të ndryshuar, i cili gjendej në shqyrtim e pritej të miratohej, ndër të tjera, ishin propozuar ndryshime në nenin 87, ku pikat 1 dhe 2 do të specifikojnë se: "1. AMA ka të drejtë t'u vendosë OSHMA-ve detyrime të arsyeshme, për transmetimin e një ose më shumë programeve audio dhe audiovizive, ofrimin e shërbimeve shoqëruese të tyre, udhëzuesit elektronik të programit (EPG), ndërfaqet e programeve aplikative, veçanërisht shërbimeve që mundësojnë akses të përdoruesve me aftësi të kufizuar. Këto detyrime vendosen ndaj operatorëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike, rrjetet e të cilëve shfrytëzohen nga një numër i konsiderueshëm përdoruesish fundorë si mjet kryesor për marrjen e programeve audiovizive. 2. Detyrimet e mbartjes sipas pikës 1, vendosen vetëm kur ato janë të nevojshme për të përmbushur objektivat e interesit të përgjithshëm dhe janë proporcionale dhe transparente

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.GJ	TV Klan	"E diela shqiptare"	7.03.2023

1. Objekti i Ankesës

A.GJ iu drejtua Autoritetit të Mediave Audiovizive, me një ankesë, me objekt:

1. *Emisionin "E diela shqiptare", ku Kryetari i Bashkisë së Tiranës fliste për makinat elektrike duke bërë autoklamë në kuadrin e fushatës elektorale edhe pse s'kishte filluar zyrtarisht përdorimi i sponsorizuar apo falas i hapësirës publike televizive kombëtare...*

si edhe duke kërkuar llogari, për:

2. *detyrimet e AMA-s lidhur me verifikimin/parandalimin e reklamave mediatike politike të fshehura brenda programeve me shikueshmëri të lartë,*
3. *masat, që merr AMA në raste të tilla,*

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s iu përgjigj pretendimeve të ankuesit, si vijon :

1. *transmetimi i reklamave politike gjatë periudhës zgjedhore rregullohet sipas dispozitave të Ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe Ligjit nr.8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar dhe është, subjekt monitorimi i KQZ-së.*

2. *verifikimi apo parandalimi i reklamave mediatike politike të fshehura brenda programeve me shikueshmëri të lartë, parandalimi nuk është në tagrin e Këshillit të Ankesave, i cili ndërmerr verifikim të përmbajtjes audiovizive bazuar në ankesat e publikut.*

3. *Këshilli i Ankesave pas marrjes së ankesës dhe shqyrtimit të materialit audioviziv, nëse evidenton shkeljet e pretenduara nga ankuesi, vepron në zbatim të Ligjit Nr.97/2013 "Për Mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	Top Channel	BBVA 2	10.03.2023

1. Objekti i Ankesës

Dhjetëra ankues iu drejtuan me ankesë Këshillit të Ankesave pranë AMA-s, për të kërkuar *"zbardhjen e televotimit të datës 4-7 mars 2023, pasi dyshonin se në emisionin BBVA2 të datës 7 mars 2023 nuk ishte transmetuar rezultati real"*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke mirëkuptuar shqetësimin e ankuesve, Këshilli i Ankesave i informoi ata, se kërkesa ishte jashtë objektit të veprimtarisë dhe kompetencave të Autoritetit të Mediave Audiovizive, veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ky ligj, apo edhe aktet nënligjore të dala për dhe në zbatim të tij, nuk parashikojnë ndërhyrjen e

AMA-s në pretendime që dalin nga mosmarrëveshje të natyrës tregtare vetëm mes palëve private.

Në rastin konkret, bëhej fjalë për një çështje kontraktuale private mes konsumatorit/abonentit, kompanisë telefonike dhe subjektit audioviziv në fjalë, i cili nga ana e tij, kishte kontratë tregtare me kompaninë telefonike. Këshilli i Ankesave sqaroi, se shqyrtimi i kontratave të kësaj natyre nuk është kompetencë e AMA-s, sepse OSHMA nuk ka madje as detyrimin ligjor për ta depozituar këtë lloj marrëveshjeje në AMA.

Në vijim, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, pavarësisht se ankuesit ishin përfshirë në procesin e votimit, të organizuar nga OSHMA-ja në fjalë me vullnetin e tyre të lirë, u sugjeroi që t'i drejtoheshin Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorëve, për një analizë të detajuar të problematikës që ata referonin.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale	Disa subjekte	Disa formate	17/03/2023

1. Objekti i Ankesës

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përmes shkresës nr.515/3 prot., datë 15.03.2023 i kaloi Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive ankesën e shtetasit A.Gj. me objekt "refuzimin e dhënies së informacionit në rrugën e kërkuar (postare) dhe kopjeve të dokumenteve zyrtare në përgjigje të kërkesës së tij për informacion"

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përgjigje të shkresës së Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Këshilli i Ankesave u përgjigj, si vijon:

1. Në vijim të ankesave, që më datë 17 janar 2023, iu drejtuan Këshillit të Ankesave për formatin "Big Brother Vip", lidhur me një bisedë me përmbajtje të papërshtatshme, ky i fundit konstatoi shkelje etike dhe referuar Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (neni 4 pika 2/d dhe dh, neni 32,pika 4, neni 33 pika 1/ç dhe d) si dhe të Kodit të Transmetimit , miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, (Seksioni 1, pika 1.5 dhe 1.6), Këshilli i Ankesave pranë AMA-s përmes shkresës nr.277/1 prot datë 18.01.2023 i tërhoqi vëmendjen operatorit audioviziv "Top Channel" për

shkeljen e mësipërme. Sa i takon emisionit "Zemër Luana", të moderatores Luana Vjollca, transmetuar në televizion Klan, pranë Këshillit të Ankesave nuk ka pasur ankesa.

2. AMA nuk aplikon censurë ndaj përmbajtjeve që transmetohen. Nëse nga ankesat referuar rasteve konkrete apo nga shqyrtimet me vetëiniciim të përmbajtjeve të transmetuara identifikohet mosrespektimi i kërkesave të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar si dhe akteve të tjera nënligjore në "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi atëherë AMA aplikon masën e tërheqjes së vëmendjes për subjektin e licencuar, nëse ai nuk është përsëritës dhe nëse po, sanksione të ndryshme, të parashikuara në legjislacion.
3. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) me propozim të Këshillit të Ankesave prej muajit Maj 2022 – Shkurt 2023, ka miratuar dy sanksione financiare, gjobë, (referuar nenit 33 të Ligjit nr.97/2013), kur subjektet audiovizive nuk respektojnë detyrimet që rrjedhin prej tij (i cili përfshin edhe shkelje etike dhe përmbajtje e papërshtatshme). Konkretisht, në vitin 2023 Autoriteti i Mediave Audiovizive ndëshkoi "TV Top

Channel" me gjobë, për shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, për emisionin "E diell", rubrika "Rrethi katror" të datës 05 qershor 2022.

4. Sa i përket pretendimit të z.Artur Gjino për kthimin e përgjigjes vetëm në rrugë elektronike (me email) dhe jo në formë shkresore, Këshilli i ankesave sqaroi, se sipas nenit 14 të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", "*Mënyrat e dhënies së informacionit*", "*..2.Kërkesat që lidhen me dokumente të shkruara trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit b) një kopje të plotë të informacionit*

nëpërmjet postës elektronike kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet. 3... informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik." Duke qenë, se në rastin konkret, kërkuari për informacion Z.Artur Gjino e akseson rregullisht adresën e tij elektronike (pasi ka konfirmuar të ketë marrë përgjigjet e AMA-s), komunikimi me mail nuk paraqet asnjë cenim apo kufizim të së drejtës së personit për informim, pasi informacioni i përcjellë zyrtarisht në rrugë elektronike ka të njëjtën vlerë ligjore si ai i përcjellë në rrugë shkresore fizike.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.Gj	-	-	17/03/2023

1. Objekti i Ankesës

A.GJ iu drejtua Autoritetit të Mediave Audiovizive, me një ankesë, me objekt:

- moszbatimin e afateve që përcakton ligji për kthimin e përgjigjeve (me postë)*
- riadministrimin e ankesës së dt.13 mars 2023 përgjigja e së cilës konsiderohej e pakënaqshme*

si edhe duke kërkuar llogari, për:

- kompetencat e AMA-s kundrejt televizioneve kablore, për t'i detyruar të vendosin në platformat e tyre televizionet kombëtare*
- vonesën e përgjigjes për ankesën e dt.27 shkurt 2023*

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Lidhur me mënyrën e përcjelljes së informacionit, Këshilli i Ankesave sqaroi, se sipas nenit 14, pika 3 e Ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit: ...b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet" dhe "kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik."

Lidhur me pikën e dytë të ankesës, Këshilli i Ankesave sqaroi, se monitorimi dhe shqyrtimi i përmbajtjeve të transmetuara audiovizive

bazohet në kërkesat e Ligjit 97/2013, i ndryshuar, në kërkesat e Kodit të Transmetimit, si aktet e tjera nënligjore në fuqi. Dy janë qasjet e AMA-s për shqyrtimin e përmbajtjeve të transmetuara: duke monitoruar kryesisht –ex officio, apo duke shqyrtuar ankesat e publikut.

Lidhur me kanalet kablore apo digjitale, Këshilli i Ankesave sqaroi, se në nenin 87 të Ligjit organik nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet se: "1. AMA ka të drejtë t'u vendosë OSHMA-ve detyrime të arsyeshme për transmetimin e një ose më shumë programeve audio dhe audiovizive me interes të përgjithshëm për publikun, me qëllim marrjen e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë në nivel kombëtar, rajonal ose lokal. 2. Detyrimet e mbartjes, sipas pikës 1 të këtij neni, imponohen në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe transparencës, vetëm ndaj operatorëve të komunikimeve elektronike, rrjetet e të cilëve shfrytëzohen nga një numër i konsiderueshëm përdoruesish, si mjet kryesor për marrjen e programeve audiovizive, dhe vetëm nëse kjo është në interes të publikut". Në zbatim të parashikimit ligjor të sipërcituar, AMA me vendimin nr. 4, datë 26.03.2014, ka miratuar detyrimin e mbartjes së programeve të televizioneve kombëtare "TVSH", "TV Klan", "TV Top Channel", nga ana e subjekteve kablore të licencuar/autorizuar për zonat që nuk mbulojnë me sinjal nga ofruesit e shërbimit të programit kombëtar audioviziv. Ndërkohë Gjykata Administrative e Apelit, pas investimit gjyqësor nga shoqëria "Top Channel" sh.a., dhe "Tv Klan" sh.a., ka vendosur lënien në fuqi të

vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë, Tiranë, e cila ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 4, datë 26.03.2014 të AMA-s. Në këtë kuadër AMA si institucion i pavarur publik, kompetencat dhe veprimtaria e të cilit përcaktohen sipas burimeve të së drejtës në fuqi në RSH, zbaton vendimin e Gjykatës Administrative. Edhe në projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën Shqipërisë", të ndryshuar, i cili është në shqyrtim e pritet të miratohet brenda vitit 2023, ndër të tjera, janë propozuar ndryshime në nenin 87, ku pikat 1 dhe 2 do të specifikojnë se: "1. AMA ka të drejtë t'u vendosë OSHMA-ve detyrime të arsyeshme, për transmetimin e një ose më shumë programeve audio dhe audiovizive, ofrimin e shërbimeve shoqëruese të tyre, udhëzuesit elektronik të programit (EPG), ndërfaqet e programeve aplikative, veçanërisht shërbimeve që mundësojnë akses të përdoruesve me aftësi të kufizuar. Këto detyrime vendosen ndaj operatorëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike, rrjetet e të cilëve shfrytëzohen nga një numër i konsiderueshëm përdoruesish fundorë si mjet kryesor për marrjen e programeve audiovizive. Lidhur me pikën e tretë, Këshilli i Ankesave sqaroi, se operatorët kabllorë janë subjekte tregtare që aktivitetin e tyre e ushtrojnë mbi kontratat që lidhin me palët e treta që i kanë këto të drejta. Operatorët kabllorë janë ritransmetues të kontentit televiziv dhe në asnjë rast prodhues të këtij kontenti, pra ato thjeshtë ritransmetojnë kanalet e një pakete televizive, me te cilën kanë lidhur një

marrëveshje. Kabllorët aktivitetin e tyre e kryejnë mbi bazën e pagesave nga klienti fundor dhe nuk mund të transmetojnë kanale, për të cilat nuk kanë marrëveshje. AMA kontrollon kabllorët vetëm për respektimin e të drejtave të transmetimit të kanaleve, që këta operatorë kanë kontraktuar me mbajtësit e të drejtave të transmetimit. AMA nuk detyron asnjë subjekt kabllor për mbartjen e kanaleve kombëtare. Lidhur me mbulimin me sinjal nga TV kombëtare në Fier, Këshilli i Ankesave sqaroi, se duhet saktësuar zona konkrete ku pretendohet që nuk aksesohet sinjali i këtyre televizioneve, sepse nga matjet e kryera nga AMA ndër vite për qytetin e Fierit, një fenomen i tillë nuk konstatohet. Këshilli i Ankesave sqaroi edhe, se kanalet kombëtare nuk e kanë detyrim mbulimin 100% të territorit të vendit. Ato duhet që mesatarisht të mbulojnë 80% të territorit të vendit dhe nga matjet e kryera në terren nga AMA, kjo përqindje rezulton e zbatuar nga të gjithë operatorët kombëtarë.

Lidhur me pikën e katërt të ankesës, e cila i referohet ankesës së datës 27 shkurt 2023, Këshilli i Ankesave sqaroi, se përgjigja pasi ishte dërguar me email, ishte ridërguar edhe përmes shkresës, dërguar ankuesit dhe Komisionerit, dt. 23.03.2023, nr.1266/1.

Lidhur me kompetencat e AMA-s përkitazi emërtimeve të emisioneve në gjuhë të huaj, Këshilli i Ankesave sqaroi, se referuar ligjit në fuqi, AMA nuk u sugjeron subjekteve të licencuara mënyrën e emërtimeve të emisioneve të tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.Gj	-	-	17/03/2023

1. Objekti i Ankesës

A.GJ iu drejtua Autoritetit të Mediave Audiovizive, me një ankesë, me objekt:

1. administrimin e ankesave të veta paraardhëse në raport me ligjin 97/2013 pa pasojë censurimin, kontrollin e rreptë dhe ndëshkimin me gjobë për shkelë
2. mënyrën e censurimit nga ana e AMA-s të emisioneve, për të cilat ankohet publiku
3. mungesës së shembujve në përgjigjen e ankesës paraardhëse, përkitazi parregullsisve të konstatuara në përmbajtjet audiovizive të monitoruara.
4. reklamën, që kryetari i Bashkisë i bën Tiranës me fonde publike pa nisur fushata elektorale dhe transmetimin e spotit në rjete sociale dhe televizione lokale e qendrore.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përgjigje të ankesës, Këshilli i Ankesave iu përgjigj shtetasit A.Gj., si vijon :

1. Këshilli i Ankesave shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të nenit 33 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në bazë të një formulari ankesë i cili përcakton saktësisht subjektin audioviziv ku është

transmetuar materiali si dhe datën dhe orën e saktë të transmetimit. Në rast ankesë në lidhje me një problematikë të caktuar, duhet plotësuar Formulari i Ankesës, që gjendet në link-un e mëposhtëm.

<http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/11/Formular-Ankesë-per-Shkeljen-e-Kodit-te-Transmetimit.pdf>

2. Për pretendimet e pikave nr.2 dhe nr.3, Këshilli i Ankesave sqaroi, se përgjigjet ishin ezauruar dyfish: me email dhe përmes shkresës për Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, datë 23.03.2023 nr.1266/1.
3. Lidhur me pretendimin nr.4, Këshilli i Ankesave i kërkoi ankuesit specifikimin e përmbajtjes audiovizive, për të cilën ankohej, duke identifikuar subjektin e licencuar, emisionin, dhe orarin, nëpërmjet plotësimit të formularit bashkëlidhur.
4. Sa i takon mënyrës së dhënies së informacionit, Këshilli i Ankesave e sqaroi ankuesin bazuar në nenin 14, pikat 2 dhe 3 të Ligjit "Për Të Drejtën e Informimit", sipas të cilit "informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik."

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.GJ	TV Klan	E diela shqiptare	27.03.2023

1. Objekti i Ankesës

A.GJ iu drejtua Autoritetit të Mediave Audiovizive, me një ankesë, me objekt:

1. *Emisionin "E diela shqiptare", ku Kryetari i Bashkisë së Tiranës fliste për makinat elektrike duke bërë reklamë në kuadrin e fushatës elektorale edhe pse s'kishte filluar zyrtarisht përdorimi i sponsorizuar apo falas i hapësirës publike televizive kombëtare...*
2. *zaptimin e hapësirës publike televizive në mënyrë të paekuilibruar nga individë apo forca të tjera politike*
3. *fshehjen brenda emisionit "E diela shqiptare" të një reklame të pastër televizive nga kryetari i Bashkisë Tiranë.*
4. *transmetimin e një spoti publicitar me zë e figure të kryetarit të Bashkisë Tiranë në rrjete sociale dhe në televizione.*

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përgjigje të ankesës, Këshilli i Ankesave u përgjigj, si vijon :

1. Përmbajtja e transmetuar më 05.03.2023, së cilës ankuesi i referohej, ishte pjesë e një rubrike të veçantë që emisioni ka hapur që në fillim të vitit 2023, saktësisht më 15.01.2023, e cila ka vijuar për disa javë. Rubrika "Pak vëmendje" i dedikohet aktivitetit të Bashkisë së Tiranës, duke e parë atë në aspekte të veçanta: njëherë duke vendosur në qendër të rubrikës profilin e një punonjëseje të pastrim gjelbërimit dhe rekreacionit në zonën e Parkut të Liqenit Artificial të

Tiranës; një herë tjetër duke u fokusuar te zjarrëfikësit e kryeqytetit; një javë më pas, duke u fokusuar tek edukatorët e kopshteve, për të vijuar me portretizimin e elektrikistëve që punojnë për ndriçimin e territorit të Bashkisë së Tiranës, punëtorëve të mirëmbajtjes-kanalizimeve; punonjëseve të pastrimit të rrugëve dhe shesheve publike në kryeqytet ku, pas disa javëve, përfshihej edhe një bisedë me kryetarin e Bashkisë së Tiranës, në të cilën shpjegoheshin aspekte të punës së këtij institucioni vendor. Në kuptimin e Ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, reklama prezantohej si "çdo formë e publikimit të transmetuar kundrejt pagesës ose përfitimeve të tjera nga një sipërmarrje publike ose private apo nga një person për qëllime vetëreklamuese, lidhur me veprimtari të veta tregtare e fitimprurëse, profesionale ose ekspertizë, si dhe për mbështetjen e pajisjes me mallra ose shërbime, përfshirë këtu pasuri të paluajtshme, të drejta e detyrime të tjera, përkundrejt pagesës" (neni 3/pika 27) Sipas ligjit 97/2013, neni 39, "Reklama konsiderohet politike në rastet kur: a) përkrah interesat e partive politike, grupeve politike ose udhëheqësve politikë, në kërkim të qëllimeve politike; b) ndikon mbi një ndryshim ligjor; c) ndikon mbi një vendim politik ose administrativ; ç) ndikon mbi një formim të opinionit të publikut, në lidhje me çështje politike të diskutueshme. 2. Reklama konsiderohet politike në rastet kur porositetit e saj janë: a) partitë politike dhe institucionet; b)

- organizatat që synojnë të përkrahin dhe ndërmarrin veprimtari politike; c) organizatat, platformat dhe kolektivat të cilët përkrahin një ndryshim ligjor ose normativ me qëllim që të mbrojnë objektivat e tyre; ç) çdo person ose grup tjetër të cilët përkrahin një projekt të veçantë ose program politik. 3. Gjatë periudhës zgjedhore transmetimi i reklamave politike bëhet sipas dispozitave të Ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar.
2. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si një autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive. Bazuar në këtë ligj, "veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë", neni 4/pika1/a). Një ndër objektivat e veprimtarisë së AMA-s është "të sigurojë ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias" (neni 18, pika1/b)
 3. Sa më sipër, AMA nuk është autoritet censurues dhe nuk ndërhyr në politikën editoriale të operatorëve mediatikë audiovizivë për sa kohë nuk evidenton shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
 4. Këshilli i Ankesave shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të nenit 33 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në bazë të një formulari ankese i cili përcakton saktësisht subjektin audioviziv ku është transmetuar materiali si dhe datën dhe orën e saktë të transmetimit:
<http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/11/Formular-Ankese-per-Shkeljen-e-Kodit-te-Transmetimit.pdf>

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.Gj	TV Klan TOP Channel	Në kurthin e Piter Panit Për'puthen	28.03.2023

1. Objekti i Ankesës

A.GJ iu drejtua Autoritetit të Mediave Audiovizive, me një ankesë, me objekt:

1. Mënyrën e kontrollit të mediave në mbrojtje të teleshikuesit, moshave të mitura gjatë transmetimeve kryesisht direkte në televizionet Top Channel dhe TV Klan, në emisionet BBVA, "Për'puthen" dhe emisionin e Luana Vjollcës. Në BBVA të dt.25 mars ora 21:00 bëhet një diskutim i tejzgjatur për çështjen, nëse disa nga banorët janë seksi apo nuk janë. Po në BBVA, dt.17 mars pati një puthje midis dy banoreve femra.
2. Mungesën e gjobave për parregullsi në fjalor dhe moszbatim të etikës televizive, mbështetur në ligjet në fuqi.
3. Deklaratat e pavërtetuara (që merren si të mirëqëna nga publiku, pra si të vërteta) lidhur me numrin e klikimeve të emisioneve televizive në rrjetet sociale Tik Tok apo You tube (në emisionin "Në kurthin e Piter Pan", Alketa Vejsiu në emisionin e dt.3 mars deklaroi se emisioni ka patur 43 milion klikime në Tik Tok, shifër kjo e pabesueshme. Ankuesi kërkonte , që stafi i TV Klanit ta ilustronte këtë me ndonjë foto a video, në mënyrë që publiku të mund ta besonte).
4. Rastin, kur një politikan me apo pa status si Sali Berisha pushton ekranet e gjithë televizioneve private, lokale e kombëtare jo vetëm një ditë (dt.1 shkurt 2023) po për javë të tëra (bashkangjitur)
5. Mungesën e masave kufizuese deri në ndalimin e daljeve të tilla, që përbëjnë

dhunim të hapësirës publike, e cila nuk i përket vetëm një personi, partie apo shoqate, por publikut

6. Emisionin "E diela shqiptare" ku Kryetari i Bashkisë Tiranë z.Erion Veliaj flet për makinat elektrike dt. 5 Mars 2023, ku i bëhet reklamë kryetarit në detyrë, edhe pse fushata elektorale, duke shpërdoruar hapësirën publike televizive në një televizion kombëtar.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përgjigje të ankesës, Këshilli i Ankesave u përgjigj, si vijon :

1. Nga shqyrtimi i materialit audioviziv të programit Big Brother Albania VIP 2 të datës 25 Mars 2023 (prime-time) në lidhje me pretendimin e ankuesit se "...bëhet një diskutim i tejzgjatur për çështje që disa nga banorët janë seksi apo nuk janë", Këshilli i Ankesave nuk konstatoi shkelje të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe as të Kodit të Trasmemitit. Pas verifikimit të materialit audioviziv të programit Big Brother Albania VIP 2 të datës 17 mars 2023,(prime time) në lidhje me pretendimin e ankuesit se "pati një puthje midis dy banoreve femra" Këshilli i Ankesave nuk evidentoi transmetimin e një episodi të tillë.
2. Përkitazi kësaj pike, u konsiderua se përgjigja ishte ezauruar me përgjigjen

- ndaj shkresës së tij të mëhershme (nr.799 Prot., datë 13.02.2023).
3. Verifikimi i numrit të klikimeve të emisioneve televizive në rrjetet sociale (Tik Tok apo You tube) është jashtë objektit të veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive, veprimtaria e të cilit bazohet në Ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili ka për "Fushë e zbatimit" (neni 2), "transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre."
 4. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) vepron në bazë e për zbatimin e dispozitave të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si një autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive. Bazuar në këtë ligj, "veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë", neni 4/pika1/a). Gjithashtu, një ndër objektivat e veprimtarisë së AMA-s është "të sigurojë ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias" (neni 18, pika1/b). Sa më sipër,
- AMA nuk është autoritet censurues dhe nuk ndërhyr në politikën editoriale të operatorëve mediatikë audiovizivë për sa kohë nuk evidenton shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
5. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) merr masa kufizuese dhe ndaluese vetëm në raste evidentimi të shkeljeve të Ligjit për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë.
 6. Përgjigja konsiderohet e ezauruar me informacionin e dhënë nga AMA në përgjigje të shkresës së tij të mëhershme (nr. 1357 Prot , datë 27.03.2023). "Transmetimi i reklamave politike para dhe gjatë periudhës zgjedhore rregullohet sipas dispozitave të Ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (Neni 20, 91, 92) dhe Ligjit nr.8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar dhe është subjekt monitorimi i KQZ-së, Komisioni Rregullator i të cilit ka për këtë një vendim të posaçëm (Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020).

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.B	-	-	08.05.2023

1. Objekti i Ankesës

E.B iu drejtua Autoritetit të Mediave Audiovizive për ndihmë në formulimin e një ankese.

2. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ankuesit iu bë me dije se Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive

(AMA) shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të nenit 33 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, që paraqitet përmes plotësimit të një formulari ankese, ku përcaktohet saktësisht subjekti audioviziv, ku është transmetuar materiali, data dhe ora e saktë e transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.L	-	-	19.05.2023

1. Objekti i Ankesës

L.L iu drejtua Autoritetit të Mediave Audiovizive për ndihmë në formulimin e një ankese.

2. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Ankuesit iu bë me dije se Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive

(AMA) shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të nenit 33 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, që paraqitet përmes plotësimit të një formulari ankese, ku përcaktohet saktësisht subjekti audioviziv, ku është transmetuar materiali, data dhe ora e saktë e transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
P.P	"Top Channel"	Serial	25.05.2023

1. Objekti i Ankesës

P.P. i drejtoi Autoritetit të Mediave Audiovizive një ankesë në përgjithësi lidhur me mosrregullimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuar dëgjimi në transmetimet audiovizive, shoqëruar me një kërkesë për informacion lidhur me rregullimin, që ligji për mediat audiovizive parashikon për titrimin e përmbajtjeve audiovizive në transmetim.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të adresimit të ankesës dhe ofrimit të informacionit të kërkuar në kuadër të saj, ankuesit iu sqarua se AMA është organi rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audiovizive që vepron në bazë të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nga i cili rrjedh edhe Kodi i Transmetimit.

Neni 47 i këtij ligji, në seksionin "Rregulloret e transmetimit", pika 1/c, përcakton "AMA, në përputhje me kërkesat e neneve 43 – 46 të këtij ligji miraton rregullore për masat e veçanta, që ofruesi i shërbimit mediatik duhet të ndërmarrë për të realizuar marrjen nga personat që kanë një shkallë të caktuar paaftësie dëgjimi ose shikimi të programeve të transmetuara".

Neni 118 i Ligjit për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë kur flet për përmbushjen e qëllimeve kryesore të veprimtarisë së RTSH-së detyron transmetuesin e shërbimit publik të sigurojë sa më shumë akses që të jetë e mundur për të

gjithë individët në Republikën e Shqipërisë.(Pika 2/a)

Neni 18 i Ligjit nr.97/2013 në seksionin "Objektivat e veprimtarisë së AMA-s" nxit "realizimin e një mjedisi rregullator, që lehtëson zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive në Shqipëri dhe që është i përgjegjshëm për nevojat e dëgjuesve e shikuesve dhe në veçanti për personat me nevoja të veçanta shqisore".(pika 2/d)

Neni 32 përcakton rregullat e përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive, duke i detyruar "Shërbimet e transmetimeve audiovizive të marrin parasysh nevojat e personave me nevoja të veçanta shqisore"(pika 5).

Edhe përditësimet më të fundit të Ligjit nr. 97/2013, të ndryshuar, nëpërmjet Ligjit nr. 30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 97/2013", "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", hyrë së fundmi në fuqi, synojnë të përmirësojnë kuadrin rregullator dhe detyrimet e OSHMA-ve lidhur me aksesin në informacion për kategori të caktuara individësh, përfshirë atë të personave me aftësi të kufizuar.

Kështu, neni 32/2 i këtij ligji parashikon se: "Neni 32/2

- Ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive marrin masa proporcionale që programet e transmetuara prej tyre të jenë të arritshme në mënyrë graduale dhe progresive nga personat me aftësi të kufizuar.
- Ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive hartojnë plane veprimi mbi aksesin në mënyrë progresive në

shërbimet e ofruara prej tyre nga personat me aftësi të kufizuara.

3. *Ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive informojnë periodikisht AMA-n për masat e marra për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni brenda vitit kalendarik.*
4. *AMA cakton një pikë kontakti në faqen e saj zyrtare, lehtësisht të arritshme nga dhënie e informacionit dhe marrjen e ankesave në lidhje me çështjet e përmendura në këtë nen. 5. Ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive sigurojnë që informacioni në rast emergjencash, përfshirë komunikimet publike dhe njoftimet në rast fatkeqësish natyrore, të ofrohet në mënyrë të tillë që të jetë i arritshëm nga personat me aftësi të kufizuara".*

Më tej, Këshilli i Ankesave sqaroi ankuesin se edhe Kodi i Transmetimit miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228 datë 11.12.2017 e përfshin këtë çështje në një seksion të dedikuar (seksioni nr.6) por fokusohet në përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuara për transmetim dhe për ndërgjegjësimin në shoqëri dhe në institucione të ndryshme lidhur me përgjegjësinë ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Udhëzimi i vetëm i përcaktuar në Kodin e Transmetimit (Seksioni 6/pika 6.1) është që ofruesit kombëtarë të shërbimeve të mediave audiovizive janë të detyruar të përdorin gjuhën e shenjave në të pakën një prej edicioneve të lajmeve, me qëllim garantimin e të drejtës së informimit për personat me nevoja të veçanta shqisore.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
T.Th	-	-	31.05.2023

1. Objekti i Ankesës

T.Th i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin se përdorimi i fjalës "kinezëri" në media përbënte diskriminim ndaj përfaqësuesve të kësaj kombësie.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i mesazhit të ankuesit u konstatua mungesa e disa elementëve të rëndësishëm të ankesës, të cilët mundësojnë administrimin e shkeljes së pretenduar. Ankueses iu sqarua, se Autoriteti shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të Ligjit nr.

97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bazuar në një Formular Ankesë, ku përcaktohet saktësisht subjekti audioviziv, ku është transmetuar materiali, data dhe ora e saktë e transmetimit. Formulari, i cili gjendet në anën e djathtë, në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive (ama.gov.al) pas plotësimit të të dhënave të mësipërme dërgohet me e-mail në adresën elektronike: info@ama.gov.al. Gjithashtu, ankesat mund të depozitohen edhe përmes shërbimit postar ose dorazi në zyrën e protokollit pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA). Sa më sipër, ankuesit iu kërkua të specifikonte saktësisht subjektin audioviziv, programin, datën dhe orën e saktë të transmetimit, ndaj të cilit kishte ankesë."

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.M	-	-	06.06.2023

1. Objekti i Ankesës

E.M i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive me pretendimin: "*media dhe dhjetëra e dhjetëra portale kanë publikuar jo vetëm emrat tanë por edhe emrat dhe të dhënat e tjera personale të fëmijëve tanë*".

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) pasi mori në shqyrtim ankesën i bëri me dije ankueses se për administrimin e ankesës së saj, duhej specifikuar media, data dhe ora e saktë e transmetimit të përmbajtjes audiovizive, objekt ankesë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
P.P	-	-	13.06.2023

1. Objekti i Ankesës

P.P i drejtoi një ankesë të përgjithshme Autoritetit të Mediave Audiovizive, me pretendimin se *"në disa OSHMA, ka përmbajtje audiovizive diskriminuese ndaj komunitetit LGBT dhe disa aktivisteve të barazisë gjinore..."*, të cilën e shoqëronte me një kërkesë për informacion lidhur *"me ankesat e të njëjtin objekt, të administruara më parë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive"*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pasi informoi, se për administrimin e ankesës, duhej specifikuar media, data dhe ora e saktë e transmetimit të përmbajtjes audiovizive, objekt ankese, Këshilli i Ankesave iu përgjigj pyetjeve të përfshira në ankesë, si më poshtë vijon:

1. AMA nuk ka marrë asnjë ankesë, me objekt pretendimin, se "komuniteti LGBT synon të zëvendësojë termat "nënë" dhe "baba" me "prindi 1" dhe "prindi 2"
2. Pranë Këshillit të Ankesave nuk ka mbërritur asnjë ankesë, me objekt diskriminimin e vajzave dhe grave politikane apo aktivistes Zhaklin Lekatari. Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar dy ankesa me objekt diskriminimi gjinor dhe komunikim joetik:
 - një ankesë, referuar emisionit "Style Star", transmetuar në televizionin "Abc News" më datë 11.04.2022, ku ankuesja pretendonte se në emisionin në fjalë, njëri prej

anëtarëve të jurisë kishte përdorur shprehje diskriminuese dhe bullizuese ndaj njëres prej konkurrenteve femra, pjesëmarrëse në emision. Përmbajtja e transmetuar u shqyrtua dhe në të u identifikuan shkelje në fashën kohore 22:21-22:25, ku një prej anëtarëve të jurisë, pjesë e emisionit argëtues, kishte përdorur fjalor krejt të papërshtatshëm, ndaj një konkurrenteje, duke përdorur etiketime fyese dhe denigruese. Situata kishte dalë nga kontrolli në komunikimin e mëpasshëm, duke prodhuar dialog të tensionuar, pavarësisht ndërhyrjeve të moderatores së emisionit për të qetësuar palët. Fjalori aspak etik, aq me tepër në formën e një sulmi denigrues ndaj një femre konsiderohet i papranueshëm. Emisioni ishte me regjistrim, por kjo nuk ishte shfrytëzuar nga produktioni për të shmangur tensionin e krijuar, ashtu siç ishte vepruar me mbulimin zanor të disa fyerjeve në dialogun vijues mes anëtarit të jurisë dhe konkurrentes.

reagime të shumta dhe shqetësim i opinionit publik ndaj një episodi të emisionit "Më lër të flas", transmetuar në televizionin "Top Channel" në datën 03.06.2022, ora 21.00, të cilat merrnin shkas nga perceptimi si "mesazh seksual" i disa sekuencave të përmbajtjes së

këtij programi, të transmetuara në një orar, kur mund të ndiqej dhe nga fëmijët. Gjatë këqyrjes së materialit filmik, Këshilli i Ankesave evidentoi se loja me personazhet e ftuara, gjatë së cilës vajzat spërkaten me qumësht nga mikrofoni me të cilin këndojnë, linte vend për keqinterpretim. Përtej kësaj, Këshilli i Ankesave evidentoi edhe: përdorim të fjalorit banal dhe të papërshtatshëm në një orar që ndiqet nga fëmijët, mungesë të shenjave paralajmëruese për programet që cenojnë të miturit. Duke qenë se konstatoi shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 228 datë 11.12.2017. Sa më sipër, AMA i tërhoqi vëmendjen për shkelje të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit" Këshilli i Ankesave kërkoi: marrjen e masave teknike në të ardhmen për të shmangur në transmetimet tuaja fjalorin e papërshtatshëm, vendosjen e shenjave paralajmëruese, sipas përcaktimeve të Kodit të Transmetimit në pikën 5.48 të tij dhe mostransmetimin e përmbajtjeve audiovizive që cenojnë rregullat e etikës dhe moralit publik,

3. Referuar nenit 20 të Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, "*Këshilli i Ankesave, me ekspertizë të pavarur, mund të organizojë anketime të publikut për problemet etike të programeve.*

Përfundimet që nxjerr nga studimi i anketimeve dhe nga ankesat e publikut ia raporton AMA-s, duke sugjeruar masat për përmirësim. Përfundimet mund të publikohen edhe në mjetet e informimit publik". Në këtë kuadër Këshilli i Ankesave në muajin nëntor të vitit 2016 ka zhvilluar një anketim për një sërë çështjesh përkitazi: respektimit të dinjitetit dhe të drejtave të tjera themelore të njeriut, mbrojtjes së të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizim të opinionit publik dhe respektimit të normave morale dhe etike në programet televizive. Anketa synonte sigurimin e një perceptimi tërësor mbi situatën e medias në Shqipëri, e në veçanti mbi punën e gazetarëve; lirinë që ata kanë për t'u shprehur; raportin e ekranit me qytetarët dhe aksesin e këtyre të fundit, interferencat politike në televizione, etj. Anketimi u zhvillua në të dyja gjinitë (femra-meshkuj), në disa nivele arsimimi (tetëvjeçar, të mesëm, universitar dhe pasuniversitar) si dhe në tri grupmosha (18-34 vjeç; 35-49 dhe mbi 50 vjeç).

- Gjetjet e anketimit përkitazi "lirisë së gazetarëve për t'u shprehur", rezultuan të diferencuara sipas nivelit arsimor të të anketuarve: sa më pak të arsimuar të pyeturit aq më negativ perceptimi dhe e anasjelltas, sa më të arsimuar të pyeturit, aq më pozitiv perceptimi;
- Gjetjet e anketimit përkitazi "zërit të qytetarëve në ekran", rezultuan "interesante", pasi ndryshe nga debatet në jetën e përditshme, shumica e të anketuarve - duke iu referuar mesatares së përgjithshme - mendonin se qytetari ka akses në ekran. Përgjigjet sipas gjinisë, nivelit arsimor dhe grupmoshave ofronin

pamje mikse nisur nga interesat dhe qëllimet e krijimit të aksesit të qytetarëve në ekran.

- Gjetjet e anketimit përkitazi "shkeljeve etike në programet televizive", treguan se të gjitha grupet e intervistuar bashkohen në një pikë: situata lë shumë për të dëshiruar. Kështu mendon pjesa dërrmuese e të anketuarve, përkundrejt vetëm 16% që mendojnë ndryshe. Ndërkohë vetëm 2% e femrave mendojnë se "respektohet dinjiteti" - kjo gjini që është edhe më pranë ekraneve televizive ndjehet e cenuar nga programet televizive që ajo ndjek.
- Gjetjet e anketimit përkitazi "cenimit të fëmijëve" evidentuan, se rreth 46% e të anketuarve vlerësonin se ka shumë emisione që cenojnë psikologjinë e fëmijëve. Perceptimi nuk varion sipas gjinisë, nivelit arsimor dhe moshave të të anketuarve.

Për të dhëna më të detajuara lidhur me përmbajtjen e anketimit, ankuesi u orientua në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive, (ama.gov.al; konkretisht http://ama.gov.al/ova_dep/buletini-i-ankesave/ (Buletini i Ankesave, Nr.1)

4. Raporti vjetor për veprimtarinë e AMA-s gjatë vitit 2015, është i publikuar në website-in e AMA-s (<http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Raporti-vjetor-AMA-2015.pdf>) Këshilli i Ankesave e ka filluar funksionimin e tij si strukturë në përbërje të AMA-s (Autoritetit të Mediave Audiovizive), në vitin 2016.
5. Në periudhën e referuar, pranë Këshillit të Ankesave nuk ka patur asnjë ankesë apo denoncim në lidhje me një video të zonjës Majlinda Bregu, e cila, sipas ankuesit , është ricikluar në disa media edhe disa herë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Avokati i Popullit	-	-	23.06.2023

1. Objekti i Ankesës

Avokati i Popullit i drejtoi një shkresë Autoritetit të Mediave Audiovizive, me anë të së cilës *"kërkohej informacion lidhur me mënyrën e trajtimit të ankesës së znj. E.M, në emër të familjarëve të V.Kaçorrit"*.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Institucionit të Avokatit të Popullit iu bë me dije se ankesa e znj.E.M, i ishte drejtuar Autoritetit me shkresën nr.2088 prot., datë 06.06.2023, me pretendimin: *"Që prej ditës kur Prokuroria e Posaçme shpërndau në media informacionin mbi vënien nën sekuestro të pasurive tona, ku përfshiheshin edhe emrat e fëmijëve, të gjitha mediat audio dhe audiovizive si dhe me dhjetëra e dhjetëra portale kanë publikuar jo vetëm emrat tanë por edhe emrat dhe të dhënat e tjera personale të fëmijëve tanë..., mediat e risjellin historinë e familjes sonë në kujtesën e publikut*

duke përfshirë edhe fëmijët. I kërkojmë Autoritetit të Mediave Audiovizive, t'u kërkojë mediave që të mos përfshijnë në asnjë rast në informacionet e tyre emrat e fëmijëve tanë".

Në vijim Avokatit të Popullit iu sqarua, se Autoriteti i Mediave Audiovizive në kuadër të administrimit të anklesës i ka kërkuar ankueses specifikimin e mediave, datës dhe orës së saktë të transmetimit të përmbajtjes audiovizive, referuar Ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, neni 52 "Shqyrtimi i ankesave", sipas të cilit "Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrton çdo ankesë, lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të nenit 33 të Ligjit nr. 97/2013, në bazë të një formulari ankese i cili përcakton saktësisht subjektin audioviziv ku është transmetuar materiali si dhe datën dhe orën e saktë të transmetimit". Informacionet e kërkuara prej ankueses – në kohën e dhënë - nuk ishin vënë ende në dispozicion Autoritetit të Mediave Audiovizive.

The first part of the document discusses the importance of maintaining accurate records of all transactions. It emphasizes that every entry, no matter how small, should be recorded to ensure the integrity of the financial data. This includes not only sales and purchases but also expenses, income, and any other financial activities.

The second part of the document provides a detailed breakdown of the accounting process. It outlines the steps from recording transactions to the preparation of financial statements. This includes identifying the accounts affected by each transaction, debiting and crediting the appropriate accounts, and ensuring that the accounting equation remains balanced.

The third part of the document focuses on the analysis and interpretation of the financial data. It discusses how to use the information provided by the financial statements to assess the company's financial health, identify trends, and make informed decisions. This involves comparing current performance with historical data and industry benchmarks.

The final part of the document concludes with a summary of the key points discussed. It reiterates the importance of accuracy, consistency, and transparency in the accounting process. It also provides some final thoughts on the role of accounting in the overall success of a business.